



AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

KRYESIA

Raport

Për veprimtarinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë vitit 2019

I. Reforma ligjore dhe institucionale

Përmbyllja e miratimi i akteve ligjore e nënligjore si bazë kryesore për reformimin e ASH qenë angazhimi kryesor i Asamblesë, drejtuesve të Akademisë së Shkencave (më tej: ASH) dhe grupit të punës të ngritur në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve (më tej: MAS).

Projektligji i hartuar nga grupi i punës i qe përcjellë MAS për miratim të mëtejshëm që në maj të vitit 2018, pasi kishte marrë mbështetjen e shumicës dërrmuese të anëtarëve të Asamblesë dhe të institucionit më prestigjioz e më kompetent në këtë drejtim, Presidencës së ALLEA-s dhe departamentit juridik të Akademisë *Leopoldina* të Gjermanisë, si dhe të institucioneve të tjera akademike të konsultuara.

Meqenëse procedura e miratimit të projektligjit mbeti një periudhë e pezullt dhe ndërkohë vazhdonte debati mediatik për efektivitetin e reformës së ndërmarrë duke i kundërvënë alternativa të patrupëzuara në projektligj, Asambleja mori disa vendime të rëndësishme në muajin shkurt 2019.

Asambleja e ASH shprehu mbështetjen e saj të plotë për projektligjin në tërësi, duke theksuar se ai siguronte reformimin e ASH, pasi:

- Reforma tejkalonte dilemat për një akademi me apo pa institute, duke i njohur ASH ushtrimin prej saj të rolit aktiv në kërkimin shkencor sipas mundësive dhe nevojave të kohës;

- U jepej përgjigje ligjore përpjekjeve për të shërbyer si reformë praktikat e mëparshme të dështuara;

- Ofronte një sërë përparësish dhe përmirësimesh, si: vendosja e kriterëve dhe procedurave rigoroze për pranimin e anëtarëve të rinj, mbështetur mbi indeksime e rankime të gjithëpranuara, me pjesëmarrjen e institucioneve kryesore të arsimit dhe shkencës; rritja e transparencës në organizimin e funksionimin e ASH nëpërmjet komisioneve; hapja ndaj bashkëpunëtorëve në rrjetin e universiteteve të vendit dhe implikimi i tyre i drejtpërdrejtë juridik për përrurimin e kandidaturave të reja për anëtarësimet në Asamble; ngritja e njërive të kërkimit shkencor në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë e ato të kërkim-studimit; si dhe korrigjimi ligjor i pasojave negative të vitit 2008 (heqja e së drejtës së votës me kriterë moshore, për të ndikuar politikisht).

Asambleja e ASH, për të mos lejuar deligjitimin dhe vetëshuarjen e saj për shkak të kufizimit antikushtetues të së drejtës së votës dhe të mbarimit të mandatit të sekretarit shkencor, pranoi që të zbatoheshin vendimet e gjykatave, duke rikthyer normalitetin në funksionimin e ASH si organ qendror dhe duke zhvilluar zgjedhjet për organet drejtuese sipas ligjit në fuqi.

Zhvillimi me sukses e konform ligjit dhe statutit i zgjedhjeve më 24 maj, me pjesëmarrjen e tërë trupës akademike (si rrallë herë), riktheu normalitetin e legjitimitetin e funksionimit të ASH, si dhe bindjen se reforma është në drejtimin e duhur. Kjo i dha mundësi ASH të nisë bashkëpunimin me komisionin parlamentar të edukimit dhe me Këshillin e Ministrave, për të realizuar procesin e shqyrtimit dhe miratimit përfundimtar të projektligjit të ri, që u votua në Kuvend më 18 qershor 2019, me 82 vota pro.

ASH argumentoi para Kuvendit dhe opinionit rëndësinë dhe vlerat e projektligjit për reformimin e vetë ASH, si një nga institucionet më të rëndësishme të shkencës në vend.

Pas miratimit të projektligjit dhe zhvillimit të zgjedhjeve legjitime, përsëri u shfaqën përpjekje për të penguar reformimin e ASH, duke mos u dekretuar as Ligji 53/2019, as Kryetari i zgjedhur.

Debati i zhvilluar në komisionin e edukimit dhe në Kuvend për “arsyet” e këtyre bllokimeve nxorën edhe një herë në pah vlerat e reformës së ndërmarrë dhe faktin se bllokimet bëheshin për shkaqe të tjera, deri antikushtetuese, për ta penguar për arsye aspak dashamirëse e konstruktive.

I vetmi argument, i stërperifrazuar, për kthimin e ligjit në Kuvend, ishte “meraku” se ASH dilte mbi institucionet e arsimit të lartë dhe shkelte autonominë e tyre, ndërkohë që tërë hapat e mëtejshëm të ndërmarrë për zbatimin e reformës dëshmojnë në kundërtën.

Pas miratimit përfundimtar të ligjit dhe hyrjes në fuqi të tij, si dhe pas konstituimit të Kryesisë, me vendim të Asamblesë, nëpërmjet votës legjitime të 24 majit 2019, ASH ndërmoi hapat për zbatimin e tij.

Brenda një afati njëmuor u hartua dhe u miratua prej Asamblesë Statuti i ri, i cili u jep një frymëmarrje të re organeve drejtuese të ASH, duke filluar nga Asambleja; rrit transparencën e pjesëmarrjes në vendimmarrje; rregullon procedurat e zhvillimit të mbledhjeve; përcakton qartë kriteret dhe procedurat për pranimet e reja, si dhe statusin e anëtarëve të Asamblesë e të anëtarëve të nderit; formulon qartë funksionet dhe aktivitetet kryesore të ASH, dhe rregullat e funksionimit të strukturave pranë saj.

Në bazë të Statutit të ri u bë përcaktimi i komisioneve që do të ngrihen pranë ASH, si dhe anëtarësia e tyre, çka përbën një hapje të dukshme të ASH ndaj institucioneve të arsimit të lartë dhe botës akademike.

U ndërmor iniciativa për ngritjen e disa njësive studimore-kërkimore pranë ASH, risi kjo që e mundëson ligji i ri.

U shpallën fushat e konkurrimit për anëtarë të rinj: 6 në shkencat teknike-natyrore dhe 4 në fushat e shkencave shoqërore dhe albanologjie; si dhe fillimi i procedurës së avancimit për dy fusha ekzistuese.

ASH u angazhua drejtpërdrejt në koordinimin e veprimeve institucionale për futjen në një kohë sa më të shpejtë të eurokodeve të sizmologjisë në projektet e ndërtimit të strukturave rezistente e të qëndrueshme sipas kategorive në fushën e ndërtimit, duke iu përgjigjur me zgjidhje shkencore problemeve të rënda të shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit. Për këtë u ngrit njësia përkatëse nën drejtimin e prof. Shyqyri Aliajt.

ASH konceptoi organizimin e organeve drejtuese ekzekutive të administratës, në të cilën u përfshi për herë të parë funksioni i kancelarit dhe një nënstrukturë për monitorimin e kërkimit shkencor e projektet, si dhe ka filluar puna për hartimin e rregulloreve të reja për çmimet, këshillin botues, administratën, ceremonialin e protokollin, të cilat do të miratohen brenda janarit.

Krahas punës për reformën, ASH ka zhvilluar veprimtari shkencore sipas programit të saj vjetor, me gjithë kushtet e vështira të kuptueshme të këtij viti.

II. Veprimtaria shkencore dhe botuese e ASH gjatë vitit 2019

A-1. Konferencat

Me gjithë vështirësitë e njohura për shkak të gjendjes jonormale juridike deri në mesin e vitit 2019, ASH ka kryer veprimtari institucionale sipas detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të saj.

ASH është institucioni propozues i aktit nënligjor të miratura nga *Këshilli i Ministrave për organizimin shtetëror të kretimeve të jubileut të 75-vjetorit të Çlirimit*. ASH u ngarkua si një prej institucioneve kryesorë organizues dhe u përfaqësua me anëtarin e saj në komitetin shtetëror shkencor të kretimeve. Propozimet e Akademisë së Shkencave për: 1. Organizimin e konferencës shkencore mbarëkombëtare e ndërkombëtare *Antifashizmi popullor ndër shqiptarët*; 2. Përkthimin dhe botimin shqip të dy veprave të autorëve britanikë për antifashizmin në Shqipëri: *Eight hour from England* (Sir Anthony Quayle) dhe *The Wildest Province: SOE in the Land of the Eagle* (prof. dr. Roderick Bailey); 3. Dhënien e çmimeve shkencore për veprat më cilësore të botuara nga autorë vendës dhe të huaj gjatë periudhës 1991-1999; u konfirmuan nga komiteti shkencor shtetëror dhe u mbështetën me buxhet.

1. Konferenca shkencore ndërkombëtare *Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore* u përgatit nga një komision shkencor mbarëshqiptar, me përfaqësues nga të gjitha institucionet akademike dhe universitare në Shqipëri, Kosovë, në Maqedoninë Veriore, Mal të Zi dhe nga bota arbëreshe. Kjo konferencë u përgatit si një ngjarje shkencore në lartësinë e periudhës historike, duke përgënjeshtuar opinionet tendencioze që sunduan në shtyp për një periudhë më shumë se tremujore. Temat kuadër të konferencës janë: *Shqipëria dhe aleatët antifashistë; qëndresa antifashiste në viset shqiptare; Fronti Nacionalçlirimtar dhe antifashizmi, si dhe mbrojtja e të rrezikuarve në luftë nga shqiptarët*. Në konferencë u mbajtën 27 kumtesa, prej të cilave 13 të paraqitura nga autorë të ardhur nga jashtë kufijve të Shqipërisë (Britani, SHBA, Zvicër, Itali, Slloveni, përveç studiuesve nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut). Është

vlerësuar se konferenca realizoi një standard tjetër të kërkimeve për këtë periudhë që gjendet prej dekadash në qendër të debateve. Rezultatet shkencore të kërkuesve pjesëmarrës rikonfirmuan vlerën dhe rëndësinë e rreshtimit të popullit shqiptar në krahun e duhur të historisë.

2. Me mbështetjen e ASH dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, u realizua në një kohë rekord përkthimi dhe botimi i dy veprave cilësore për antifashizmin popullor të shqiptarëve dhe u bë përrurimi të tyre: *Lufta e fshehtë në Shqipëri: Misionet britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore*, me autor studiuesin britanik të Universitetit të Oxford-it prof. dr. Roderick Bailey dhe *Tetë orë nga Anglia*, me autor Sir Anthony Quayle. Përrurimi u shoqërua me hapjen e ekspozitës dokumentare me foto origjinale, të pabotuara më parë.

3. U shpall konkursi, u ngrit juria, u hartua rregullorja dhe u përcaktuan kriteret e përzgjedhjes, nominimit dhe shpalljes së fituesve të konkursit ndërkombëtar për veprat më cilësore për antifashizmin në Shqipëri (botuar në periudhën 1991-2019). Juria ndërkombëtare, midis rreth 700 titujve të botimeve me këtë problematikë, shpalli si vepra fituese: a). Për autorët vendës, monografinë *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore* të historianit Paskal Milo; b). Për autorët e huaj, monografinë *Lufta e fshehtë në Shqipëri - një histori e misioneve britanike 1940-1945* të studiuesit britanik Roderick Baiely.

Konferenca, botimi i dy studimeve të vlerësuara prej historianëve recensues si *standard i ri i shkrimit historiografik* dhe organizimi e shpallja e fituesve të dy çmimeve të mëdha, përbëjnë veprimtarinë më të rëndësishme shkencore të vitit 2019 në fushën e shkencave shoqërore dhe albanologjike. Seksioni përkatës i këtyre dy fushave (SSSHA) ka pasur rolin e organizatorit, bashkorganizatorit, kontribuesit shkencor dhe të mbështetjes institucionale edhe në 8 konferenca të tjera, sipas pasqyrës këtu poshtë:

1.	Institucion organizator kryesor	2
2.	Institucion bashkorganizator	4
3.	Institucion kontribues	2
4.	Institucion mbështetës	1

Në pasqyrën vijuese jepen të dhëna sintetike për konferencat e SSSHA

1.	Kongrese / konferenca ndërkombëtare	5
2.	Konferenca mbarëshqiptare	2

3.	Konferenca kombëtare	1
----	----------------------	---

Anëtarët e Asamblesë kanë marrë pjesë në projekte europiane e rajonale, si dhe në kongrese, konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, duke referuar shqip e në gjuhë të huaja, në tërësi së në pasqyrën në vijim¹:

Pjesëmarrës gjithësej në projekte nga anëtarët e SSHSHA	16
Nga këto projekte ndërkombëtare	7
Pjesëmarrës gjithësej në projekte nga anëtarët e SSHTN	12
Nga këto projekte ndërkombëtare	12
Pjesëmarrës në projekte nga Asambleja	28
Nga këto në projekte ndërkombëtare	19
Pjesëmarrës në konferenca shkencore nga anëtarët e SSHSHA jashtë vendit	25
Pjesëmarrës në konferenca shkencore nga anëtarët e SSHSHA brenda vendit	24
Gjithësej nga SSHSHA	49
Pjesëmarrës në konferenca shkencore nga anëtarët e SSHSHA jashtë vendit	31
Pjesëmarrës në konferenca shkencore nga anëtarët e SSHSHA brenda vendit	3
Gjithësej nga anëtarët e SSHTN	34
Gjithësej nga anëtarët e Asamblesë	83
Nga këto jashtë vendit	59

Konferencat shkencore të ASH jepen të renditura sipas peshës që kanë mbajtur seksionet (SSHSHA dhe SSHTN). Ato paraqiten në *Aneksin nr. 1*. SSHSHA është gjithashtu organizues i veprimtarive përruese, që jepen në *Aneksin nr. 2*.

Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore (në vijim: SSHTN) ka pasur këto veprimtari shkencore:

¹ Sipas vetëraportimeve nga anëtarët e Asamblesë (shih Aneksin nr. 5).

Forume shkencore	5
Konferenca / seminare shkencore	2
Leksione të hapura	2
Tryeza të rrumbullakëta të debatit shkencor	2
Programi <i>Edukimi në shkencë</i>	2

Nga të dy seksionet, veçmas e së bashku, janë organizuar gjithësej 19 veprimtari shkencore, nga të cilat një konferencë mbarëkombëtare.

A-2. Botimet

Këshilli i botimeve miratoi për botim për vitin 2019 32 tituj studimesh monografike nga autorë anëtarë të Asamblesë dhe bashkëpunëtorë:

Botime të akademikëve	Botime të bashkëpunëtorëve
13 tituj	19 tituj

Struktura e botimeve të miratuara është si më poshtë:

Shkencat shoqërore e albanologjike	Shkencat teknike dhe natyrore
30	2

Me një vendim rishikues këshilli i botimeve ka zëvendësuar dy tituj dhe raporti midis dy seksioneve rezulton 30 : 2.

Ndarë në disiplina struktura e botimeve është kjo:

Arkeologji	1
Histori	2
Trashëgimi materiale dhe jomateriale	16
Gjuhësi	5
Letërsi	3
Mjekësi	1
Terminologji	1

Bibliografi	1
Muzikologji	2

Në mënyrë të detajuar veprimtaria e ASH si ent botues shihet në *Aneksin nr. 4*. Ndërsa të dhënat përmbledhëse për veprimtarinë botuese të anëtarëve të Asamblesë jashtë programit të botimeve të ASH referuar raportimeve vetjake është si në pasqyrën e mëposhtme:

Studime monografike	
Akademikë në SSHSHA	13
Akademikë në SSHTN	6
Gjithësej monografi	19
Numri i botimeve të akademikëve nga ASH si ent botues gjatë vitit 2019	13

Këshilli i botimeve, mbështetur në *Memorandumin* e nënshkruar midis ASH dhe ASA, miratoi si botime të përbashkëta edhe:

- L. Malltezi, E. Kambo, M. Verli (përg.), *Shqipëria në vitin 1914*, vëll. I;
- M. Verli (përg.), *Shqipëria në vitin 1914*, vëll. II;
- B. Meta (përg.), *Shqipëria në vitin 1914*, vëll. III-IV;
- B. Meta, M. Verli (përg.), *Shqipëria në vitin 1914*, vëll. V.

ASH boton rregullisht periodikët *Studia Albanica* dhe *JNTS*, dy revistat që promovojnë studimet më cilësore të kërkuesve shqiptarë për botën e jashtme.

Revista e SSHTN është e vetmja në Shqipëri me IF. Revista *Studia Albanica* është e regjistruar si tribunë shkencore me ISSN.

Pas një gjendjeje të bllokuar prej tre vjetësh, një prapambetje që ka krijuar probleme edhe me promovuesit ndërkombëtarë të shkencave albanologjike, me një ndërhyrje të vendosur të Kryesisë situata në revistën *Studia Albanica* u zgjidh. Redaksia u plotësua, kryetarja e SSHSHA rimori detyrën si kryeredaktore sipas Statutit, dy numra të vitit 2016 kanë hyrë në shtyp, dy numra të vitit 2017 janë duke u përgatitur, dy numra të vitit 2018 janë rezervuar për aktet e konferencës kushtuar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe për dy numrat e vitit 2019 është përzgjedhur lënda.

Për hollësi në lidhje me botimet shih *Aneksin nr. 4*.

Veprimtaria botuese e anëtarëve të Asamblesë në revista shkencore jashtë tri revistave të ASH paraqitet me këto të dhëna:

Artikuj shkencorë të botuar ose të pranuar për botim jashtë vendit nga anëtarë të SSHSHA	17
Artikuj shkencorë të botuar ose të pranuar për botim jashtë vendit nga anëtarë të SSHTN	56
Gjithësej	73
Artikuj shkencorë të botuar ose të pranuar për botim brenda vendit nga anëtarë të SSHSHA	12
Artikuj shkencorë të botuar ose të pranuar për botim brenda vendit nga anëtarë të SSHTN	7
Gjithësej	19
Artikuj të botuar nga anëtarë të Asamblesë brenda dhe jashtë vendit sipas raportimeve vetjake	75

Disa nga përparësitë kryesore në veprimtarinë botuese të ASH për vitin 2020:

Nr.	Autor	Titulli
1.	Kristo Frashëri	<i>Skënderbeu, jeta dhe vepra (anglisht)</i>
2.	Eqrem Çabej	<i>Studime etimologjike në fushë të shqipës, vepra e plotë, vëll. I-VIII</i>
3.	Apollon Baçe	<i>Arkitektura në Iliri (anglisht)</i>
4.	AA VV	<i>Besimet dhe bashkëjetesa e shqiptarëve</i>
5.	Dhori Qirjazi	<i>Vepra e plotë e Thimi Mitkos</i>
6.	AA VV	<i>Aktet e konferencës së 75-vjetorit të Çlirimit</i>
7.	Kristina Jorgaqi	<i>Fjalori i Konicës</i>
8.	AA VV	<i>Burime arkivore austriake, viti 1914, vëll. I-VI</i>
9.	AA VV	<i>Burime arkivore austriake, viti 1915, vëll. I-III</i>
10.	Matteo Mandalà	<i>Historia e mërgimit të arbëreshëve</i>
11.	KNKGJSH	<i>Akte vendimore të KNKGJSH</i>
12.	AA VV	<i>Studia Albanica, nr. 1-2</i>
13.	AA VV	<i>JNTS, nr. 1-2</i>
14.	Akademia e të Rinjve	<i>Studime të zgjedhura</i>

A-3. Çmimet

Konkursi i çmimeve të mëdha vjetore të ASH organizua sipas rregullores dhe kalendarit, me një juri ndërkombëtare, vendimet e së cilës nuk u kontenstuan nga asnjë prej konkurrentëve. Përzgjedhja e veprave më cilësore për *konkursin e çmimeve shkencore kombëtare* për vitin 2018 u bë me një konsultim të gjerë ekspertësh të fushave. Ndarja e çmimeve u parapri me ligjërata promovuese të autorëve të veprave të nominuara. *Çmimi i karrierës* u fitua nga akad. Luan Omari. Me çmimin *Çabej* juria vlerësoi veprën *Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX* (grup autorësh), ndërsa çmimi *Radovicka* iu akordua veprës *Atlas i florës së Shqipërisë* të akad. Jani Vangjelit me bashkautorët. Studiuesit Belisa Muka dhe Giuseppe Lepore fituan çmimin e kërkuesit të ri më të suksesshëm për veprën *La necropoli meridionale di Phoinike: le tombe ellenistiche e romane*.

Gjatë vitit 2019 u zhvillua gjithashtu konkursi ndërkombëtar për veprën më cilësore monografike kushtuar antifashizmit në Shqipëri dhe rreshtimin e shqiptarëve në krahun fitimtar të aleancës antifashiste, në përfundim të të cilit u shpallën dy vepra fituese: *Lufta e fshehtë në Shqipëri - një histori e misioneve sekrete britanike (1940-1945)*, me autor studiuesin Roderick Bailey (Oxford University) dhe *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore* (vëll. I), me autor historianin Paskal Milo. Nuk pati fitues për autorë të rinj.

Në *Aneksin nr. 5* njoftohen të dhënat e veprimtarisë universitare e akademike të anëtarëve të Asamblesë, me qëllim transparence, brenda dhe jashtë ASH.

Shërbimi i financës

Veprimtaria e sektorit të financës është kontrolluar nga KLSH, institucioni më i lartë i ngarkuar nga ligji me këtë detyrë, për periudhën e 2017-2018, dhe është vlerësuar për korrektesë dhe ligjshmëri. Nuk ka pasur asnjë propozim për masë administrative dhe ndëshkimore dhe asnjë konstatim për shkelje.

Është hartuar dokumenti përfundimtar i buxhetit, llogaritja e kostove nga drejtuesit e programeve dhe krijimi i regjistrit të riskut.

Sektori ka mbajtur marrëdhënie të vazhdueshme me ISSH dhe drejtorinë e tatimeve për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore; ka ndjekur në vijimësi sipas ligjit procedurat ekonomiko-financiare të tenderimit. Rasti më i rëndësishëm është prokurimi i botimeve të ASH, prerj momentit të miratimit të listës së botimeve nga këshilli i botimeve deri në miratimin e çmimeve të shitjes nga Ministrisë së Financave (32 tituj, nga të cilët 4 numra periodikësh). Sipas rekomandimit të KLSH, për të përmirësuar shërbimin me librin u prokurua programi informatik-financiar *Alpha*.

Gjatë zbatimit të buxhetit janë bërë edhe ndryshime të pjesshme, duke përfshirë zhvendosje nga një zë në tjetrin, në përputhje me rregullat në fuqi.

ASH është e përfshirë institucionalisht në këto projekte e programe: 1. Projekte në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe artistik ASH-ASHAK (*shpenzime për Kosovën.*, art 604); 2. Projekte në kuadër të marrëveshjeve shumëpalëshe (*Marrëveshje mbi bashkëpunimin në vendosjen e një sistemi kombëtar bibliografik për vlerësimin e rezultateve të kërkimit shkencor në Shqipëri*, projekti Cobiss); 3. Projekte të mbështetura nga AKSHI për financimin e projektit TIS - *Temporary Immersion System*, sipas kontratës së financimit nr. 276/1 datë 25.09.2019. Këto projekte janë realizuar sipas tabelës nr. 1 në Aneksin nr. 6.

Një pasqyrë përmbledhëse për programin *Veprimtari akademike* jepet në tabelën nr. 2. Art. 600 është realizuar 83.8 %; art. 601 është realizuar 84.9 % dhe në art. 602 realizimi i fondeve është 99.99 %. Produkti 92201AA përmban shpenzimet për kërkim-zhvillimin me impakt në zhvillimin KZHT&I dhe është plotësuar 99.95 %. Peshën më të madhe e ka zënë zëri *qera godine*, për të cilin janë paguar 5746135 lekë. Produkti 92201AB përmban shpenzimet për kartat e eventeve për politikën shkencore dhe qeverisje të KSHT&I me impakt në kërkim-zhvillim. Produkti 92201AC përmban shpenzimet kërkimore-

shkencore me nivel të lartë shkencor në fushat prioritare për kërkim dhe zhvillim (*publikime shkencore*), ku përfshihen *botime e monografi* dhe revistat periodike *JNTS* dhe *Studia Albanica*.

Botimet gjatë vitit 2019, përveç detyrimeve me subjektin kontraktues në vlerën 6132640 lekë, peshësuficike kanë zënë honoraret për autorët dhe recensat. Kontrata e botimeve për këtë vit nuk u realizua në rreth 15 % të vlerës së saj. Produkti 92201AD përmban shpenzime për çmime shkencore kombëtare. Sipas traditës institucioni organizoi konkursin vjetor.

Në zëra, struktura e buxhetit paraqitet si vijon: 1). Për *art. 604 (shpenzime për Kosovën)* shpenzimet janë realizuar 28 %; 2). Në *art. 605 (pagesa të kuotave të anëtarësisë në organizata ndërkombëtare)*: 74.3 %. 3). *Art. 606* është realizuar 76.78 %, për shkak të vendeve vakante në Asamble; 4). Në zërin 231 realizimi i fondeve është 88.6 %, rezultat i ndikimit të procedurave të prokurimit. Shpenzimet nga të ardhurat dytësore (*kap. 5*) në limitet e miratuar u realizuan si në *tabelën nr. 3 (Aneksi nr. 6)*.

Në zbatim të rekomandimit të KLSH u morën masa për shitjen dhe shpërndarjen e botimeve të ASH. Gjatë vitit 2019 janë arkëtuar 1053 mijë lekë, nga të cilat 30 % janë përdorur për nevoja të institucionit. Po kështu, janë derdhur në buxhet 79.000 lekë nga qiratë e sallave dhe nga këto të ardhura 90 % janë përdorur për nevoja të institucionit. Me autorizimin e Ministrisë së Diasporës u mundësua dhurimi i një sasive librash në Agjencinë e Zbatimit të Gjuhës Shqipe në Maqedoninë e Veriut. Kjo praktike do të vijojë edhe për vitin 2020. Probleme për sektorin e financës janë ndarja e magazinimit nga shpërndarja e librit dhe tejkalimi i vonesave të magazinimit të librave të prokuruar.

III. Disa nga përparësitë dhe veprimtaritë më të rëndësishme të dy seksioneve të ASH për vitin 2020

A. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA)

- 1. Ringritja dhe normalizimi i punës së Këshillit Ndërakademik Kombëtar të Gjuhës Shqipe, plotësimi i anëtarësisë, hartimi i rregullores, arritja e marrëveshjes me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, nisja e veprimtarisë së tij si organizëm i përhershëm kujdestar për shqipen e njësuar, me përfaqësim nga e gjithë hapësira shqipfolëse;*
- 2. Përgatitja e një projekt-ligji të ri për gjuhën shqipe në bashkëpunim me ASHAK dhe i akteve nënligjore;*
- 3. Ribotimi i Fjalorit të Drejtshkrimit, në bashkëpunim me ASHAK, me ndryshimet e miratuara nga KNKGjSh dhe me një shtojcë të akteve të vendimarrjes së tij në periudhën 2004-2019;*
- 4. Propozimi i një koncepti paraprak për kornizën ligjore dhe kushtet profesionale për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare, nismë shkencore afatgjatë, në bashkëpunim me ASHAK. Nga anëtarët e SSHSHA është propozuar përgatitja e një Fjalori të madh të gjuhës shqipe dhe i një Fjalori integral të saj, propozime çka është mirëpritur edhe nga ASHAK;*
- 5. Ngritja, stabilizimi dhe fillimi i veprimtarisë së katër komisioneve (gjuhësi-letërsi, art-trashëgimi, histori-arkeologji dhe ekonomi-drejtësi);*
- 6. Organizimi i konkursit për pranimet e reja në katër fusha të hapura rishtas dhe në një fushë ekzistuese për avancim;*
- 7. Hartimi i rregullores së re dhe organizimi i konkursit për çmimet e mëdha shkencore që jepen nga Akademia e Shkencave për vitin 2019;*
- 8. Përtëritja e anëtarësisë së SSHSHA, pranimet e reja, propozimi i anëtarëve të rinj të jashtëm dhe të nderit;*
- 9. Konferencë shkencore ndërkombëtare në 200-vjetorin e Thimi Mitkos, në bashkëpunim me ASHAK dhe institucione të tjera universitare;*

10. *Botimi i veprës dyvëllimëshe të Thimi Mitkos, vijim i projektit të nisur me botimin e Fjalëtores së tij;*
11. *Organizimi i Konferencës së 50-të Ndërkombëtare të Studimit të Baladave Baladat dhe audiencia e tyre, në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Studiuesve të Baladës;*
12. *SSHSHA është bashkorganizator me ASHAK dhe me institucione të tjera shtetërore dhe shkencore për veprimtaritë kushtuar 100-vjetorit të parlamentarizmit (botim aktesh, konferencë, rijetësimi i himnit etj.);*
13. *Konferencë dhe botim kushtuar temës *Receptimi shqiptar i nismave gjeorajonale dhe gjeokulturore kineze në Europën Qendrore*, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave Shoqërore të Kinës;*
14. *Kontribut në mbështetje të projektit ndërkombëtar *Terminologjia e tekstileve manufakturale prej pëlhure*, në bashkëpunim me Universitetin Katolik të Milanos dhe Universitetin e Kalabrisë;*
15. *Veprimtari mbështetëse për projektin ndërkombëtar të studimit të të folmeve arvanite nga studiuesit e Universitetit të Kalabrisë dhe të Universitetit të Palermos dhe të të folmeve greqishte në Italinë e Jugut;*
16. *Ringritja dhe rinistitucionalizimi i komiteteve shkencore kombëtare që përfaqësojnë vendin në organizatat shkencore europiane e botërore dhe kryerja e detyrimeve shkencore ndaj tyre (AIESEE, ALE);*
17. *Albanologjia e sotme në Shqipëri, Kosovë, në hapësirën historike shqiptare dhe në botë, konferenca e parë shkencore e studimeve albanologjike dhe krijimi e funksionimi i një rrjeti të njësuar të albanologëve;*
18. *Poezia shqipe në shekullin XX, konferencë shkencore ndërakademike, në bashkëpunim me ASHAK;*
19. *Kontribut për një botim të përbashkët të akteve të konferencës *Studimet albanistike në Itali*, organizuar nga ASHAK me mbështetjen e SSHSHA;*
20. *Përgatitjet paraprake për një konferencë shkencore mbarëkombëtare në 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit, në bashkëpunim me ASHAK dhe institucione të tjera (2022);*
21. *Botim me thirrje për kontribut për temën *Besimet dhe bashkëjetesa fetare e shqiptarëve*;*
22. *Botimi i akteve të konferencës *Shqiptarët dhe koalicioni antifashist në Luftën e Dytë Botërore*;*
23. *Stabilizimi i punës së redaksisë së revistës *Studia Albanica*, shpejtimi i punës për të tejkaluar vonesat në periodicitet dhe në kalendar;*

24. Organizimi i ligjëratave akademike me studiues të shquar, vendës dhe të huaj, për çështje që kanë lidhje me zhvillimet bashkëkohore;

25. Përurime veprash të rëndësishme të anëtarëve të SSHSHA dhe të bashkëpunëtorëve të tij.

Renditja prioritare dhe përzgjedhja përfundimtare e këtyre veprimtarive do të bëhet pas hartimit të programit institucional të punës për vitin 2020.

B. Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore (SSHTN)

I. Për protokollin e bashkëpunimit me ASHAK:

1. *Studimi i ndryshimeve mjedisore me imazhet satelitore (përfundimi i studimit aktual dhe mundësisht shtrirja në zona të tjera);*

2. *Studimi i dukurive të aerosoleve dhe ndotjeve atmosferike mbi rajonin Shqipëri-Kosovë;*

3. *Studimi i perqëndrimeve të radiobërthamave me origjinë natyrore në mineralet e nxjerra në Shqipëri dhe Kosovë;*

4. *Studimi i aktiviteteve industriale (minerare dhe metalurgjike) dhe antropologjike në ekosisteme ujore të lumenjve Ibri, Lepenc, masat për ruajtjen e mjedisit nga ndotjet në bashkëpunim me Universitetin e Mitrovicës 2020-2022;*

5. *Studimi mbi sigurimin e burimeve alternative të energjisë - aplikime industriale, në bashkëpunim me UBT, Prishtinë, 2020-2022;*

6. *Parandalimi i risqeve gjeologjike në planifikimin e zhvillimit urban (konferenca rajonale për tektonikën, sizmikën dhe inxhinierinë);*

7. *Projektimi dhe ndërtimi i sistemit /open access/ për botimet e JNTS dhe RESEARCH;*

8. *Gjeoturizmi në hapësirën ndërkufitare malore.*

II. Konferenca, forume, simpoziume etj.

1. Konferencë rajonale për sismologjinë dhe mbrojtjen nga tërmetet: mars 2020;

2. *Prodhimi dhe certifikimi i fidanëve të drurëve frutore autoktone me metoda të bioteknologjisë dhe biologjisë molekulare – kërkesë urgjente për tregun, QTTB Vlorë, prill 2020 (ASH, FShN, UT, CNR-IBE, Firenze, Itali);*
3. *Forum shkencor mbi metodologjitë inovative për simulimin e klimës në mbështetje të realizimit të zhvillimeve të pritshme në fushën e energjive të ripërtëritshme, diellore, të erës, gjeotermale, nëntor 2020;*
4. *Simpozium shkencor mbi rezultatet e interpretimeve të reja të albanideve, shtator 2020;*
5. *Forum në drejtim të promovimit të energjisë së ripërtëritshme dhe eficiencës së energjisë, në shfrytëzimin e pasurive ujore lumore, dhe problematikave që lindin në garantimin e ruajtjes së mjedisit, rehabilitimin dhe mbrojtjen e saj, nëntor 2020;*
6. *Konferencë shkencore në problematikat e sigurisë ushqimore të prodhimeve nga tregu vendës dhe importi: gjendja dhe ardhmëria, në bashkëpunim me AKU, ISUV, Universitetin Bujqësor etj.; vjeshtë 2020;*
7. *Forum shkencor në lidhje me temën e shëndetit urban në qytete të Shqipërisë, dhjetor 2020;*
8. *Veprimtari të ndryshme në përputhje me problematikat prioritare të kohës, gjatë vitit;*
9. *Takime shkencore me shkencëtarë, pasuniversitarë, grupe të palëve të interesit, komunitetit të biznesit e të prodhuesve, si dhe shoqërisë civile për problematika të kohës (SSHNT në bashkëpunim me institucione shkencore dhe mësimore, biznes dhe shoqata etj.).*

Për prioritetet do të ketë propozime dhe vendimmarrje të reja deri në fund të janarit të vitit 2020. Dokumenti përfundimtar do të diskutohet dhe miratohet përfundimisht në mbledhjen e Asamblesë në fund të atij muaji.

Shtojca analitike të raportit të analizës vjetore të Akademisë së Shkencave

Aneks nr. 1

Konferencat shkencore të vitit 2019

I. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA)

1. SSHSHA organizoi forumin publik “Përkhimi” i rritjes ekonomike në mirëqenie, i katërti në serinë e forumeve të nisura prej vitit 2014, projekt i ideuar nga akad. Kosta Barjaba. Ky forum pati si produkt të rëndësishëm botimin “Përkhimi” i rritjes ekonomike në mirëqenie, pjesë e kolanës *Forume publike të Akademisë së Shkencave*, në të cilën bëjnë pjesë edhe: **a).** *Rimodelimi i zhvillimit në kontekstet lokale*; **b).** *Asimetritë e zhvillimit, si shkak varfërie*; **c).** *Rithemelimi i mirëqenies: zhvillimi, sfidant i varfërisë*. Forumi dhe botimi vijnë si një plotësim logjik i trilogjisë dedikuar zhvillimit e mirëqenies dhe do të pasohet me edicione të tjera;
2. Konferenca akademike-universitare kushtuar 100-vjetorit të vdekjes së Ismail Qemalit me temë *Figura dhe roli i Ismail Qemalit në zhvillimet politiko-shoqërore në fillim të shek. XX dhe në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë*, organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Albanologjike (më tej: ASA) dhe Universitetin e Vlorës *Ismail Qemali*. Një cikël i dytë i kësaj konference u realizua në shtator në Tiranë, përqendruar në temën *Ismail Qemali dhe elitat politike shqiptare në procesin e shtetndërtimit*. Në komitetin shkencor organizues të kësaj konference SSHSHA u përfaqësua nga akad. Marenglen Verli, akad. Beqir Meta, akad. Floresha Dado dhe akad. asoc. Shaban Sinani. Akad. Marenglen Verli dhe akad. Beqir Meta u paraqitën me kumtesa;
3. Përfaqësues të SSHSHA morën pjesë me kumtime shkencore në *Kongresin XII të AIESEE-së*. Mbi 400 referate dhe kumtesa u mbajtën prej studiuesve nga Europa

Juglindore dhe vende të tjera. Çështjet shqiptare, më vete ose në një kuadër të ballkanologjisë, sllavistikës, helenistikës a romanistikës, zunë vend gjatë gjithë javës: mbi 25 kumtime e referate nga albanologë të huaj. Nga SSHSHA morën pjesë dhe referuan akad. Floresha Dado, akad. Albert Doja dhe akad. asoc. Shaban Sinani;

4. SSHSHA është bashkorganizues dhe kontribues në konferencën ndërkombëtare *Francesco Anton Santori: la sua opera e il suo tempo (L'apporto dello scrittore e del francescano arbëresh alla letteratura, alla lingua e alla "Rinascità" nazionale): Frangjisk A. Santori: vepra dhe koha e tij*. Konferenca në nderim të 200-vjetorit të tij u organizua me pjesëmarrjen e studiuesve nga më shumë se 15 universitete. Akad. Floresha Dado paraqiti kumtesën *Poezi apo rrëfenjëza të vargëzuara: vëllimi "Satirat" i Santorit*, ndërsa akad. asoc. Shaban Sinani kumtoi për temën *Due monografie in versione manoscritta su Francesco Antonio Santori nell'archivio dell'Istituto di Studi Linguistici e Letterari di Tirana*. Konferenca u përgatit me përgjegjësi shkencore nga akademikët Francesco Altimari e Matteo Mandalà, të cilët ishin gjithashtu referues;

5. SSHSHA ishte organizator i një pjese të rëndësishme të aktiviteteve shkencore në 70-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe RP të Kinës. Së bashku me *Beijing Foreign Studies University (BFSU)* dhe *Foreign Language Teaching and Research Press*, u bë promovimi i *Antologjisë së poezisë shqipe në dy vëllime, prej fillimeve deri në ditët tona* (zgjodhi dhe përktheu në gjuhën kineze albanologu Zheng Enbo) dhe i dy botimeve të tjera nga sinologë shqiptarë. Referues në përrurime nga SSHSHA ishin akad. asoc. Shaban Sinani dhe akad. Floresha Dado. U hap ekspozita e librave *Autorë shqiptarë për Kinën, autorë kinezë për Shqipërinë*, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare. Kryesia e ASH pati bisedime zyrtare me delegacionin e BFSU dhe midis dy institucioneve u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi për studimet albanologjike. Albanologut Zheng Enbo, anëtar i Akademisë Arteve të Kinës, iu dha mirënjohja *Nderi i Akademisë*. Në konferencën shkencore dyditore në kuadër të 70-vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Kinës, krahas BFSU, Universitetit të Vlorës *Ismail Qemali* e Universitetit të Gjirokastrës *Eqrem Çabej*, ASH kishte rolin e bashkorganizatorit. Morën pjesë 49 kumtues nga 14 institucione shkencore-universitare nga Kina, Shqipëria dhe vende të tjera. Nga SSHSHA paraqiti kumtesë akad. asoc. Shaban Sinani, anëtar i komitetit organizues;

6. Konferenca shkencore ndërkombëtare *Studimet albanistike në Itali* e organizuar në Prishtinë pati mbështetjen e SSHSHA. Kjo ngjarje shkencore, vijim i konferencës për *studimet albanistike në Amerikë* e më pas për *studimet albanistike në arealin e gjermanishtes*, rikonfirmoi nevojën dhe suksesin e bashkëpunimit ndërakademik. U mbajtën 50 kumtesa, përqendruar në kontributet e albanologëve italianë në fushë të gjuhësisë, etnologjisë, antropologjisë, letërsisë dhe historisë. Akad. Francesco Altimari, përveç referatit të hapjes, hartuar në bashkautorësi me akad. Rexhep Ismajlin, mbajti kumtesën *Ballkanizma dhe italo-romanizma në ndërtimet foljore aspektuale të arbërishtes së Italisë*. Akad. Floresha Dado referoi për temën *Prometeizmi në letërsinë shqipe sipas autorit italian Mauro Geraci*. Ndërsa akad. Matteo Mandalà u përqendrua në temën *Studimet albanologjike në Universitetin e Palermos: një shqyrtim tipologjik*. Së fundi, akad. asoc. Shaban Sinani trajtoi temën *Kadare në studimet italiane*. Pjesëmarrës ishin albanologë nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia e Veriut, nga Italia, SHBA, Bullgaria dhe Greqia, nga Franca dhe Gjermania;

7. Për konferencën shkencore kushtuar 120-vjetorit të lindjes së poetit dhe mendimtarit Lasgush Poradeci, të organizuar nga Universiteti i Korçës Fan Noli, veprimtari ndëruniversitare kushtuar personalitetit të poetit dhe mendimtarit Lasgush Poradeci, ASH ofroi mbështetje intelektuale dhe nxitje kontributesh, përkrah institucioneve organizues. Në komitetin shkencor organizues të kësaj veprimtarie SSHSHA u përfaqësua edhe nga akad. Floresha Dado dhe akad. asoc. Shaban Sinani.

I. Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore (SSHTN)

1. Në kuadër të projektit shkencor *Përmirësimi i mikroshumimit në një shkallë të gjerë të disa prej llojeve të drufrutorëve ekonomikisht të rëndësishëm përmes teknologjisë inovative të kulturës së lëngshme me zhytje të përkohshme - Temporary Immersion System (TIS)*, SSHTN organizoi konferencën shkencore ndërkombëtare *Teknologjitë inovative në mbështetje të bujqësisë dhe agroturizmit*. Në konferencë nga SSHTN u aktivizuan me kumtimet akad. Salvatore Bushati dhe akad. Efigjeni Kongjika;
2. Në kuadër të programit *Edukimi në shkencë*, prof. Agim Ballvora, që mban vlerësimin *Nderi i Akademisë* mbajti leksionin e hapur *Biologjia integrative për sfidat e së ardhmes*;
3. SSHTN organizoi forumin shkencor *Ndikimi i politikave fiskale në zhvillimin ekonomik dhe financiar të Shqipërisë*, ku u aktivizuan akad. Salvator Bushati dhe akad. Anastas Angjeli;
4. Forumi shkencor *Perspektivë mbi mikro-plastikat në natyrë dhe shoqëri* u organizua në kuadër të bashkëpunimit me *Inter-Academy Partnership (IAP)*, ku aderojnë 154 akademi. Akad. Salvator Bushati relatoi *mbi gjenerimin e mbeturinave plastike, problemet dhe perspektivat e ardhshme në Shqipëri*;
5. SSHTN organizoi forumin e hapur shkencor *Teoria e evolucionit në dritën e shek. XXI*, në kuadër të 160-vjetorit të botimit të librit të Darvinit *Mbi origjinën e specieve*. Akad. Neki Frashëri foli për kushtet historike dhe shkencore që ekzistonin në periudhën në të cilën jetoi Darvini, duke e cilësuar si *një influencues të madh në mendimin njerëzor modern*;
6. SSHTN organizoi forumin e hapur shkencor *Tabela e Mendelejevit - një shprehje e rregullit në natyrë*, në kuadër të 150-vjetorit të zbulimit. U aktivizuan me kumtime akad. Dhimitër Haxhimihali, akad. asoc. Ilirjan Malollari, akad. Floran Vila dhe akad. Neki Frashëri;
7. Në kuadër të projektit *Përmirësimi i mikroshumimit në shkallë të gjerë të disa specieve frutore me rëndësi ekonomike me anë të teknologjisë inovative të kulturës së lëngët në sistemin e zhytjes së përkohshme (VitroTIS)*, me bashkë-koordinatorë akad. Efigjeni Kongjika dhe prof. Maurizio Lambardi, u organizua një tryezë e rrumbullakët me titull *Sulla coltura liquida in "Temporary Immersion System" (TIS)*. Dy koordinatoret paraqitën projektin bilateral, qëllimin, objektivat dhe rezultatet e projektit dyvjeçar. Akad. Efigjeni Kongjika referoi për problemin *La necessità di introduzione di metodi innovativi nella produzione di piantine di specie di alberi da frutto in Albania*;
8. Në kuadër të programit *Edukimi në shkencë* SSHTN organizoi leksionin e kapur *Kozmologjia moderne dhe pafundësia e Leopardi-t* nga prof. Pietro Benvenuti. Në këtë veprimtari përshëndeti sekretari shkencor i ASH akad. Salvatore Bushati;

9. SSHTN organizoi leksionin e hapur *Problemi i mijëvjeçarit Jang-Mills* nga prof. Artan Boriçi. Akad. Neki Frashëri, që drejtoi veprimtarinë, theksoi bashkëpunimin e ngushtë dhe të vazhdueshëm që prof. Boriçi ka me SSHTN;

10. SSHTN organizoi forumin shkencor *Nga Shqipëria e vogël në universin e madh*, në kuadër të fushatës botërore të *Shoqatës Ndërkombëtare e Astronimisë* për emërtimin e disa sistemeve planetare të pazbuluara deri më sot. Akad. Neki Frashëri foli për qëllimin e kësaj veprimtarie: *paraqitja e listës së rrudhur të emrave iliro-shqiptarë* të propozuar me një pjesëmarrje të gjerë publike, që u përgatit nga një komisioni i ASH, me këtë përbërje: akad. emeritus Gjovalin Shkurtaç, akad. asoc. Shaban Sinani, akad. Floresha Dado, prof. Emil Lafe dhe prof. Seit Mancaku. Propozimi shqiptar për emrin e yllit është *Illyrian* dhe për emrin e planetit - *Arber*;

11. SSHTN organizoi simpoziumin shkencor për arritjet e projektit *Terminologjia e kimit në gjuhën shqipe dhe hartimi e botimi i "Fjalorit të termave të kimit shqip-anglisht/anglisht-shqip"*, me autorë akad. Dhimitër Haxhimihali, prof. Dritan Topi dhe prof. Eduard Andoni. Morën pjesë përfaqësues të ASHAK akad. Fetah Podvorica dhe akad. Salih Gashi.

Aneks nr. 2

Ligjëratat e hapura akademike dhe përrurimet:

1. U përrurua në Prizren *vepra e plotë e akad. Androkli Kostallarit*, botim i ASH, veprimtari e përbashkët me Universitetin e Prizrenit *Ukshin Hoti* dhe me Shoqatën e Gjuhës Shqipe;
2. U bë promovimi i kolanës së plotë me burime dokumentare të koleksionuara nga akad. Kristo Frashëri *Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe vepra*, në 9 vëllime (pa studimin monografik), botim i ASH. Seria prej 9 vëllimesh botuar në kuadër të *Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut*, është kolanë integrale e burimeve historike për heroin kombëtar shqiptar;
3. Në 60-vjetorin e lindjes së autorit u bë përrurimi i përmbledhjes së studimeve *Shfaqja e antropologjisë në Shqipëri*, botim i ASH, me shkrime të zgjedhura të akad. Albert Doja, mbledhur e përgatitur për botim nga znj. Enika Abazi;
4. SSSHSHA organizoi përrurimin e koleksionit *Këngë popullore nga Çamëria* (ribotim nga ASH) të mbledhësit Fatos Mero Rrapaj. Botimi i parë i kësaj vepre u bë në vitin 1983 po nga ASH, me një parathënie të akad. Ismail Kadare. Përgatitja e ribotimit (parathënie, fjalorth shtesë dhe redaktim) u bë nga akad. asoc. Shaban Sinani dhe prof. Hajredin Isufi;
5. Promovimi i librave *Konsullatat franceze në Shqipërinë e shekujve XVII-XIX* dhe *Udhëtim në Athinë dhe në Konstandinopojë* të studiuesit Luan Rama u drejtua nga akad. Floresha Dado dhe u realizua me bashkëpunëtorë të SSSHSHA;
6. SSHTN organizoi simpoziumin shkencor *Akad. Salvatore Bushati - një jetë në kërkimin shkencor në fushat e gjeofizikës*, me rastin e daljes nga botimi të monografisë *Bazat e gjeofizikës së zbatuar në shkencat e tokës me metodat sizmike, gravimetrike dhe studimit të puseve*, me autorë prof. Vilson Silo dhe akad. Salvatore Bushati. Veprimtarinë e hapi akad. Gudar Beqiraj, i cili foli për jetën e akad. Bushatit. Më pas u promovua vepra *Bazat e gjeofizikës së zbatuar në shkencat e tokës me metodat sizmike, gravimetrike dhe studimit të puseve*.

Aneks nr. 3

Marrëveshjet e bashkëpunimit: Përgatitje, nënshkrime, zbatime

1. *Marrëveshja e bashkëpunimit midis ASH dhe Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës Shqipe në Maqedoninë e Veriut* i angazhon palët për bashkëpunim të ndërsjelltë në funksion të kujdesit për zhvillimin dhe përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në përdorimin zyrtar, në praktikat shkresore, në shtyp dhe media. ASH mbështet agjencinë me botime dhe ekspertizë për njësimin e terminologjisë dhe pastërtinë e gjuhës. Në Maqedoninë e Veriut është themeluar *Inspektoriati për Gjuhën Shqipe* si zyrë shtetërore. Marrëveshja u nënshkrua nga akad. Skënder Gjinushi dhe dr. Ylber Sela;
2. Marrëveshja, programi dhe tematika-kuadër për organizimin e *Konferencës së 50-të Shkencore* ndërmjet *Komisionit Ndërkombëtar të Studimit të Baladave (Kommission für Volksdichtung)* dhe ASH, që do të zhvillohet në Tiranë dhe Gjirokastër vitin e ardhshëm, me temë bosht *Baladat dhe audienca në kohë dhe hapësirë* dhe do të ketë rol mbështetës edhe për regjistrimin e Festivalit Folklorik Kombëtar në programin *Best Practice* të UNESCO-s, projekt i drejtuar nga akad. Vasil S. Tole. Në komitetin shkencor të konferencës nga ASH janë akad. Vasil S. Tole dhe akad. asoc. Shaban Sinani;
3. *Memorandumi i bashkëpunimit mes ASH dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike* (më tej: ASA) për realizimin e projekteve shkencore kombëtare me vijimësi kronologjike, si *Fjalori Enciklopedik shqiptar, Atlasi Gjuhësor i shqipes*; për fushat prioritare studimore të albanologjisë, si identiteti i shqiptarëve, njësia e shqipes në përdorimin zyrtar etj.;
4. *Marrëveshja e bashkëpunimit midis ASH dhe ATSH* për realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e informimit shkencor dhe popullarizimin e shkencës. ATSH dhe ASH do të ofrojnë shërbim falas për njëra-tjetrën për sa u takon burimeve që kanë në rrjetin e tyre të arkivave dhe të bibliotekave, si dhe do të përgatiten botime me interes të ndërsjelltë në fushën e dokumentacionit të shkruar dhe në imazh;
5. *Marrëveshja e bashkëpunimit mes ASH dhe Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore* përfshin shkëmbim ekspertize dhe shfrytëzimin e eksperiencës akademike për vlerësimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore;
6. *Projekt-marrëveshja e bashkëpunimit mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut (MANU)*, bashkë me protokollin e projekteve të karakterit afatmesëm, në parim është e miratuar nga palët;

7. *Marrëveshja e bashkëpunimit midis ASH dhe Universitetit të Studimeve Ndërkombëtare të Pekinit (BFSU) dhe fillimi i punës për një marrëveshje të ngjashme me Akademinë e Shkencave Shoqërore të Kinës (CASS);*
8. *Protokolli i bashkëpunimit midis ASH dhe ASHAK për periudhën 2020-2022;*
9. *Në kuadër të protokollit të bashkëpunimit midis ASH dhe ASHAK u punua për projektin pilot Përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit, me bashkëdrejtues akad. Gudar Beqiraj nga ASH dhe akad. Nexhat Daci nga ASHAK. Grupet kërkimore përbëhen nga akad. Neki Frashëri, akad. Salvator Bushati, akad. Efigjeni Kongjika, dr. Anita Berberi; akad. Isuf Krasniqi e akad. Fejzullah Krasniqi;*
10. *Në kuadrin e bashkëpunimit shkencor Shqipëri-Itali u punua për projektin Përmirësimi i mikroshumimit në shkallë të gjerë i disa specieve frutore me rëndësi ekonomike me anë të teknologjisë inovative të kulturës së lëngët në sistemin e zhytjes së përkohshme, me bashkëkoordinatorë akad. Efigjeni Kongjika dhe prof. Maurizio Lambardi;*
11. *Në kuadër të bashkëpunimit ndërakademik e ndëruniversitar u realizua projekti dyvjeçar Fjalor i termave bazë të kimit (shqip-anglisht dhe anglisht-shqip) e akad. Dhimitër Haxhimihali (me bashkautorë), miratuar për botim për vitin 2019;*
12. *SSHTN ka punuar për realizimin e marrëveshjes midis ASH dhe Istituto Nazionale di Geofisica e Vulcanologia për ngritjen e një observatori magnetik në Shqipëri, i pari i këtij lloji në vend, nismë e akad. Salvator Bushati;*
13. *Në kuadrin e bashkëpunimit me Inter-Academy Partnership: Science-Research-Medicine ka funksionuar grupi i punës Ndotja mikro-dhe-nanoplastike në natyrë dhe shoqëri. U përgatit raporti i katërt nga konsorciumi SAPEA, Një perspektivë shkencore mbi mikroplastikën në natyrë dhe shoqëri.*

Aneks nr. 4

Botimet e ASH gjatë vitit 2019

Nr.	Autori	Titulli	
1.	AA VV	<i>Gjergj Kastrioti Skënderbeu, koha në të cilën jetoi dhe gjurmët që la në histori, vëll. II, akte të konferencës shkencore ndërkombëtare në Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut</i>	
2.	AA VV	<i>Gjergj Kastrioti Skënderbeu, koha në të cilën jetoi dhe gjurmët që la në histori, vëll. II, akte të konferencës shkencore ndërkombëtare në Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut</i>	
3.	Abaz Hado	<i>Portreti - 120 vjet histori të pikturës shqiptare</i>	
4.	Afërdita Onuzi	<i>Art popullor në Kosovë</i>	
5.	Andi Rëmbeci, Rigers Bakiu	<i>Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi</i>	
6.	Andromaqi Gjergji	<i>Veshje shqiptare ndër shekuj</i>	ASH
7.	Apollon Baçe	<i>Atlasi i qyteteve dhe i kështjellave ilire, vëll. II</i>	ASH
8.	Aurel Plasari	<i>Arbni në gjeografi dhe histori</i>	
9.	Bardhyl Demiraj	<i>Kodiku beratas</i>	
10.	Dhimitër Shuteriqi	<i>Bibliografi personale</i>	ASH
11.	Eno Koço	<i>Bota muzikore shqiptare (tradihtë dhe individualitete)</i>	
12.	Fatos Mero Rrapaj	<i>Këngë popullore nga Çamëria (ribotim)</i>	


13.	Ferid Hudhri	<i>Shqiptarët në artin botëror</i>	
14.	Floresha Dado	<i>Postmodernizmi në letërsinë e sotme shqiptare</i>	ASH
15.	Gjergj Frashëri	<i>Kruja e Skënderbeut²</i>	
16.	Holta Sina Kilica	<i>Kodikët ekfonetikë të Shqipërisë</i>	
17.	Irakli Koçollari	<i>Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës, vëll. II</i>	
18.	Josif Papagjoni	<i>Enciklopedia e artit shqiptar, vëll. I-II</i>	
19.	Kristo Frashëri	<i>Skënderbeu, jeta dhe vepra (anglisht)³</i>	ASH
20.	Maks Velo	<i>Studime mbi arkitekturën dhe artin popullor</i>	
21.	Mark Tirta	<i>Mitologjia ndër shqiptarë (ribotim)</i>	ASH
22.	Petrika Thëngjilli	<i>Ali pashë Tepelena midis legjendës dhe historisë</i>	
23.	Stefan Çapaliku	<i>Mbi estetikën e artit shqiptar</i>	
24.	Shaban Sinani	<i>Vepra e Dritëro Agollit dhe “Brezi i viteve 1960”</i>	ASH
25.	Xhevahir Spahiu	<i>Vjersha dhe poema</i>	ASH
26.	Zana Shuteriqi	<i>Muzika shqiptare (1878-1990)</i>	
27.	SSHTN	<i>Journal of Natural and Technical Sciences⁴, nr. 1</i>	
28.	SSHTN	<i>Journal of Natural and Technical Sciences, nr. 2</i>	
29.	SSHTN	<i>Journal of Agriculture of Animal Production Sciences for the Rural Development</i>	
30.	SSHSHA	<i>Studia Albanica - Akte</i>	
31.	SSHSHA	<i>Studia Albanica 1-2</i>	

² Zëvendësuar me *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ribotim, autor Dh. S. Shuteriqi.

³ Zëvendësuar me *Terminologjia bazë e kimisë*, autor Dhimitër Haxhimihali et al.

⁴ Në bordin botues bëjnë pjesë dhe akad. Efigjeni Kongjika, akad. Jani Vangjeli dhe akad. Salvatore Bushati.

Botimet, me përshkrim sipas recensioneve (Pasqyrë jo e plotë)



Demiraj, Sh., *Jul Variboba në trashëgiminë e tij*

Viti: 2019

Faqe: 249

ISBN: 978-9928-237-55-2

Mbi librin

Ky studim monografik është një vepër postume e akademikut Shaban Demiraj, kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit arbëresh Jul Variboba. Vepra, që është realizuar nga autori në vitet 1949–1951 dhe është ruajtur për një kohë të gjatë si dorëshkrim në arkivin e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, është paraqitur për botim nga i biri, prof. Bardhyl Demiraj, i cili e ka përgatitur dhe e ka pajisur atë me vërejtje kritike.

Për të ruajtur homogjenitetin e përkushtimit të autorit ndaj jetës dhe veprës së Jul Varibobës, prof. Bardhyl Demiraj ka përfshirë në këtë botim edhe dy studime të dikurshme të autorit mbi gjuhën e Varibobës dhe vlerat letrare artistike të veprës së tij, duke ia nënshtruar ato një përmirësimi të natyrës redaksionale, por pa cenuar aspak origjinalitetin e gjuhës së studiuesit dhe koloritin e stilit shkencor të kohës në të cilën u përfutuan këto studime.

Ky studim plotëson trashëgiminë shkencore të akademikut Shaban Demiraj, sikurse shtrirjen e gjerë të veprimtarisë së tij intelektuale-albanologjike, duke përditësuar formimin e tij nismëtar si filolog dhe kritik letrar i kulturës së shkrimit arbëresh në shek. XVIII-XIX ose dhe të Rilindjes.

Botimi i plotë i kësaj vepre me tejshkrim dhe kompetencë shkencore në fushën e tekstologjisë dhe të filologjisë, të historisë së shkrimeve dhe të historisë së dialekteve (duke përfshirë arbërishten), pasuron fondin e librit të nevojshëm për qëllime universitare dhe kërkimore-shkencore.



Riza, E., *Banesa popullore shqiptare me qoshk*

Viti: 2019

Faqe: 210

ISBN: 978-9928-237-54-5

Mbi librin

Në këtë vepër, botim i Akademisë së Shkencave, trajtohet banesa me qoshk, një dukuri e rëndësishme e kategorisë së banesës popullore shqiptare. Kjo banesë, me njësim të theksuar kompozicional e përhapje ballkaniko-europiane dhe më gjerë ka një vlerë të veçantë në përshkrimin e mënyrës së jetesës së shqiptarëve. Synimi për trajtimin e gjerë të kësaj teme, deri më sot të trajtuar si pjesë e trajtesave të tjera, është një ndihmesë me rëndësi për vlerësimin e kësaj pasurie historiko-kulturore. Njohja e gjerë dhe krahasimisht e thellë e këtij tipi të banesës

popullore shqiptare, pas një veprimtarie rreth gjysmëshekullore prej autorit në këtë fushë, e shfaq këtë trajtesë në përputhje me kërkesat tashmë të konsoliduara disarrafshëshe, për t'iu afruar ndjeshëm të vërtetave mbi këtë dukuri.

Monografia dallohet për hulumtimin e saj të gjerë në hapësirat shtetërore të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ajo e shtjellon temën në rrafshet kompozicionale dhe ato ndërtimore. Dokumentacioni grafik dhe fotografik që trajton vepra, ka vlera të mëdha për të sotmen dhe për të ardhmen, në vazhden e pambarimtë studimore për t'iu afruar përherë dhe më pranë të vërtetave historike. Paraqitja e shembujve më të spikatur, me vlera përgjithësuese, prej zgjidhjeve të thjeshta drejt atyre të komplikuar, e bën veprën më të qartë dhe më të lehtë për t'u mbajtur mend.

Vepra është e rëndësishme për zgjerimin e njohurive mbi vlerat e krijuara në shekuj prej shqiptarëve. Ajo u drejtohet si specialistëve të fushave, po ashtu edhe të interesuarve të tjerë, pavarësisht shkallës së njohurive mbi temën.



Çapaliku, S., Sita estetike (mbi estetikën e artit shqiptar)

Viti: 2019

Faqe: 346

ISBN: 978-9928-237-59-0

Mbi librin

Kjo vepër është një shqyrtim i imtë i disa dukurive estetike jo vetëm nga letërsia, por edhe nga arti shqiptar në përgjithësi. Ajo është pjesë e një kërkimi të ditëpërditshëm mbi atë çfarë ndodh sot në artin tonë, mbi protagonistët e tij. Mbas një eksperience të gjatë në fushën e estetikës, gjë që i ka dhënë atij një koleksion instrumentesh, autori ka nisur zbatimin e këtyre dijeve universale estetike në terrenin thuajse djerr të letërsisë dhe kulturës shqiptare.

Libri paraqet interes edhe për imazhet e tij, të cilat janë të zgjedhura me kujdes dhe të pakonsumuara më parë, gjë që e bën atë më tërheqës.

...Fatkeqësisht jemi mësuar që historia jonë e artit dhe e letërsisë, e kulturës në përgjithësi, të shkruhet pasi protagonistët të kenë vdekur, të jetë produkt kërkimesh arkivore... Nuk jemi mësuar ta shkruajmë historinë në kohën e vet, nuk e kemi pasur zakon t'i pyesim bashkëkohësit tanë, t'i intervistojmë, t'u hyjmë në studio, t'u futemi në proces, t'i bëjmë të shprehën lirisht mbi atë çka mendojnë rreth vetes dhe të tjerëve... Pikërisht këtë mangësi kërkon të plotësojë ky libër.

Ndërdisciplinariteti në metodikën e studimit të argumenteve letrare dhe artistike e bëjnë këtë botim të vlefshëm gjerësisht të përdorshëm.



Kodiku Beratas

Me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyl Demiraj

Viti: 2019

Faqe: 451

ISBN: 978-9928-237-56-9

Mbi librin

Ky botim kritik i tekstit shqip të “Kodikut të Beratit” (njohur ndryshe edhe si “Dorëshkrimi i Kostë Beratit”, kodik i fundit të shekullit XVIII ose i fillimit të shek. XIX) është një tjetër gur që plotëson mozaikun e botimit të trashëgimisë sonë kulturore-letrare, me një tekst të një periudhe kohore me trashëgimi të paktë shkrimore,

nga një hapësirë kulturore ku ka mbizotëruar gjuha greke si gjuhë e shkrimit, siç është shekulli XVIII i arealit ortodoks të Jugut.

Botimi shoqërohet me një aparat kritik të hollësishëm e të përpiktë, që i përmban të gjitha ndërhyrjet redaksionale me argumente gjuhësore-filologjike, si dhe të natyrës statistikore, shpjegime të ndryshme që lidhen me interpretimin e tekstit në aspektin gjuhësor e filologjik, të mbështetura në një shqyrtim e vlerësim të gjendjes gjuhësore të fazës së shqipes kur u shkrua teksti, të përkatësisë dialektore të autorëve të dorëshkrimit, të veçorive të shkrimit shqip në arealin ortodoks të Jugut, si dhe në traditën e botimit filologjik të teksteve të këtij areali nga studiues të mëparshëm.

Botimi hedh baza të sigurta për hulumtime të mëtejshme në gjuhën e tekstit, si përfaqësuese e toskërishtes veriore të shek. XVIII, si dhe për shumë çështje që kanë të bëjnë me historinë e shkrimit shqip me alfabetin grek e marrëdhëniet e tij me alfabetet e ndryshme origjinale, si dhe me marrëdhëniet e shkrimit në gjuhët fqinje etj.



Sinani, Sh., Vepra e Dritëro Agollit dhe Brezi i viteve 1960

Viti: 2019

Faqe: 531

ISBN: 978-9928-237-60-6

Mbi librin

Në këtë studim vëmendja qendrore u kushtohet *veprave të ndaluara të shkrimtarit Dritëro Agolli*, që nuk janë të pakta. Disa prej tyre u zhdukën përgjatë disa dekadave gati pa gjurmë. Disa të tjera për ribotimin e të cilave kërkohej ndërhyrje shfytyruese, vetë autori, i lënduar në shenjtërinë e autorësisë bëri sikur i harroi, i nxori nga mendja, ashtu si e kishin urdhëruar. Ndonjë tjetër u përpoq ta ringjallte përmes *transmodelimit gjinor*, duke i shndërruar në skenarë filmash etj.

Përveç këtyre veprave, në objektin e këtij studimi është përfshirë edhe krijimtaria e botuar pas vdekjes së autorit, për të cilën në këtë vepër është treguar kujdesi për ta çuar atë sa më denjësisht në duart e lexuesit. Gjithashtu janë përfshirë edhe ato që mund të quhen “veprat mënjane të Dritëro Agollit”, kryesisht romane që ose nuk janë përfillur fare nga studimet dhe kritika në kohën e botimit dhe më pas, ose vepra të tjera që janë ndëshkuar qysh në momentin e parë të kontaktit me kritikën dhe më tej janë harruar a kanë dalë jashtë vëmendjes.

Thuajse të harruara kanë mbetur edhe librat e publicistikës, ku shfaqet Agolli polemist, me një regjistër krejt tjetër ligjërimi, si dhe shënjime prej leksioneve universitare me të cilat u formuan disa breza gazetarësh.

Synimi i këtij studimi është që të rivendosë baraspeshën e trazuar në gjykimin e letërsisë së një shkrimtari të papërgjashmë nga historia e letërsisë shqipe, sido dhe kurdo që ajo të shkruhet, si Dritëro Agolli, në një periudhë kalimtare prej apogjeut në refuzim inatçor, prej lavdisë në shpërfillje.

Gjergji, A., *Veshjet shqiptare në shekuj (Ribotim)*

Viti: 2019

Faqe: 338

ISBN: 978-9928-237-67-5




Veshjet popullore janë një nga dëshmitë më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato janë trashëguese e transmetuese të shumë elementeve që vijnë nga lashtësia dhe nga koha e mesme, por janë njëkohësisht edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me popuj të tjerë gjatë shekujve.

Kjo vepër e akademikes së parë të Akademisë së Shkencave, studiueses së specializuar në fushën e veshjeve popullore shqiptare, është vazhdimësi e botimit dhe pasqyrimin të rezultateve të kërkimeve të gjata shkencore në terren dhe i studimeve të saj të pasqyruara në një varg artikujsh dhe në vepra përgjithësuese.

Vepra mbështetet në materiale etnografike të mbledhura në terren gjatë ekspeditash të shumta në zona të ndryshme të vendit, në njohjen e kujdesshme të koleksioneve muzeore në qendër e në rrethe dhe në një informacion të gjerë të vjelë nga literatura e nga burime të shumëllojshme dokumentare.

Autorja synon të hedhë dritë në rrugën historike të zhvillimit që ka përshkruar kjo sferë e kulturës popullore, të shtjellojë përmbajtjen dhe domethënien e pasur të formave të saj të larmishme, të zbulojë cilat janë elementet më me interes që mund t'i shërbejnë ripërtëritjes së vazhdueshme të kulturës sonë në procesin e zhvillimit të saj.



Koçollari, I., *Korrespondencë dhe dorëshkrime të Ali pashë Tepelenës*

Viti: 2019

Faqe: 765

ISBN: 978-9928-237-70-5


Mbi librin


Botimi është një përmbledhje dokumentesh tërësisht të panjohura gjer më tash, të kabinetit dhe të vetë Pashait të Janinës, Ali Pashë Tepelenës. Në to renditen letërkëmbime mes tij dhe strukturave vartëse të pashallëkut, me Portën e Lartë, me komandantë ushtarakë vendas apo të huaj, administratorë rajonesh, krahinash, qytetesh, me diplomatë, mbretër e perandorë, të njohur apo anonimë. Në radhën e dokumenteve gjenden gjithashtu njoftime dhe informacione periodike të vartësve të tij për situatën politike, ushtarake dhe atë ekonomike në rajonet shqiptare dhe greke nën kontrollin e tij dhe më gjerë.

Dokumentacioni ndriçon shumë ngjarje historike të njohura pak ose aspak gjer më tani. Mes tyre bëhen evidente personazhe që luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimet dhe rrjedhat e shekullit XVIII dhe XIX. Nën prirjet dhe tendencat për shkëputje dhe mëvetësi, dokumentacioni i Arkivit të Ali Pashës mbart fakte me interes për krijimin e institucioneve parashitetore, përpjekjet e tij të hapura dhe të fshehta për të gjetur aleatë dhe për të ndërtuar aleanca me fuqitë europiano-perëndimore, sikundër me francezët apo britanikët.

Brenda fondit të këtij arkivi gjenden marrëveshje juridike me karakter politik apo ushtarak, kontrata blerjesh apo shitblerjesh, informacione agjentësh apo diplomatësh, analiza për zhvillimet në Europë, letra të shkruara nga qytetarë të thjeshtë, ankesa për

abuzime me pushtetin, vendime gjykatash, kërkesa për falje të dënuarish, evidence për taksat dhe tatimet, fatura shpenzimesh, projekte për ndërtime dhe fortifikime, raporte nga frontet e luftimeve dhe konflikteve brenda dhe jashtë pashallëkut, intervista dhënë gazetarëve të huaj, pasqyra të transportit dhe këmbimeve të mallrave në porte dhe dogana etj.

	<p>Beci, B., <i>Historia e formimit të strukturës dialektore të shqipes</i> Viti: 2019 Faqe: 273 ISBN: 978-9928-237-69-9</p> <p>Mbi librin Ky botim paraqet gjendjen e studimeve për historinë e formimit të strukturës dialektore të shqipes dhe më tej pikëpamjen e autorit mbi historinë e formimit të strukturës dialektore të shqipes.</p> <p>Pjesa e parë e veprës bën një paraqitje të gjerë mbi pikëpamjet e ndryshme mbi këtë ndarje, për tiparet dalluese të njësive dialektore, mendimet për vjetërsinë e tyre dhe për vjetërsinë e formimit të strukturës dialektore të shqipes, pikëpamjet për vendin e formimit të njësive dialektore të shqipes dhe mendimet mbi shkaqet e formimit të kësaj strukture dialektore. Kurse pjesa e dytë paraqet qëndrimin e autorit mbi këto çështje.</p> <p>Vepra është e një rëndësie të madhe, pasi trajton historinë e formimit të strukturës dialektore të shqipes si një dëshmi të rëndësishme të vendbanimit të hershëm të shqiptarëve në gadishullin e Ballkanit.</p>
---	---

	<p>Baçe, A., <i>Qytetet dhe qytezat ilire dhe në Iliri. Pjesa e parë: Iliria Veriore (Istria-Drin)</i> Viti: 2019 Faqe: 558 ISBN: 978-9928-237-71-2</p> <p>Mbi librin Ky vëllim është pjesa e parë e serisë “Katalog i qyteteve dhe kështjellave irire dhe në Iliri”, që ka si synim krijim e një baze të dhënash sa më të plotë të qendrave urbane dhe paraurbane në hapësirën ndërmjet lumit Sava në veri, gjirit të Ambrakisë në jug, vargut Kopaonik–Gojllak–Sharr–Pind në lindje e deteve Adriatik dhe Jon në Perëndim.</p> <p>Botimi synon gjetjen e unitetit brenda diversitetit, gjenin, ku më shumë e ku më pak ilir, dhe botën e fuqishme dhe dinamike ilire, të lënë në hije nga mbindriçimi helen.</p> <p>Kjo pjesë e parë trajton aglomeracionet e Ilirisë Veriore. Ai paraprihet nga vështrimi gjeomorfografik, sintaktik dhe semiotik, përkatësisht nga një antropogjeografi që lejon ndjekjen në kohë dhe hapësirë të zhvillimit ekonomik-social dhe mënyrës së të jetuarit.</p> <p>Vëllimi ndahet në kapituj në nivel federatash dhe krahas konfigurimit gjeopolitik, në to parashtrihen sintetikusht ndodhitë historike, struktura social-ekonomike dhe bota shpirtërore-artistike.</p>
---	--

Në brendi kapitujt përmbajnë tërë qendrat e njohura qytetare dhe një numër të përfillshëm qendrash paraqytetare të paraprirra nga tabulati me parametrat bazikë, si: vendndodhja, koordinatat GPS, përmasat, fazat ndërtimore dhe largësia nga qendrat e banuara etj., të dhëna që lejojnë perceptimin momental të objektit dhe orientimin hapësinor.



Spahiu, Xh., Bota ku eci (poezi)

Viti: 2019

Faqe: 102


ISBN: 978-9928-237-61-3

Mbi librin

Akademia e Shkencave riboton vëllimin “Vdekje perëndive!” të vitit 1977 të poetit, publicistit, përkthyesit dhe akademikut Xhevahir

Spahiu.

Vargu i lirë e konciz, ritmi dinamik i ligjërimit dhe mendimi përgjithësues i shprehjes metaforike, janë tiparet dalluese të krijimtarisë poetike të Xhevahir Spahiut. Poezitë e tij me frymë qytetare e polemiste, të prira nga lirizmi, meditimi psikologjik e sentenca poetike, shpesh përjetohen si dialogë me historinë dhe aktualitetin e botës shqiptare.



Prifti, S. (përg.) Dhimitër S. Shuteriqi: Bibliografia personale për periudhën 1933-2019

Viti: 2019

Faqe: 188

ISBN: 978-9928-237-72-9

Mbi librin

Biblioteka shkencore e Akademisë së Shkencave përfundoi krijimin e bibliografisë së dytë online, atë të akademikut Dhimitër Shuteriqi.

Bibliografia e akad. Dhimitër Shuteriqit përmban 970 njësi bibliografike dhe është hartuar në bazë të tipologjisë shkencore të përcaktuar sipas standardit, kronologjisë historike dhe elementeve të tjera të përshkrimit bibliografik, është detajuar në mënyrë profesionale sipas fushave e nënfushave: monografi, artikuj, trajtesa, kumtime, përkthime, kritikë, vëzhgime, hulumtime etj.


Në këtë mënyrë hapësirat që krijon sistemi janë të shumëfishuara; përmes specifikës së kërkimit krijohen mundësi shumë të lehtësuara dhe zgjedhje sipas tipologjisë shkencore e kronologjike.

Bibliografia e akad. Dhimitër Shuteriqit është e integruar në Sistemin dhe Shërbimet e Përbashkëta Bibliografike Online (COBISS) sipas standardeve ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik, si edhe në Sistemin Informues për Veprimtarinë Kërkimore në Shqipëri (Ecris.AL).

Në fund të çdo njësie bibliografike, ndodhet ID përkatëse që e identifikon secilën njësi në këtë sistem. Format i përzgjedhur i njësisë bibliografike: ISO 690. Klasifikimi i njësisive bibliografike: tipologjia, viti, titulli.

Kjo bibliografi, ashtu si të tjerat para dhe në vijim shërbejnë si model dhe inovacion për të gjitha bibliotekat shqiptare, të cilat ndihmojnë në identifikimin dhe vlerësimin e

rezultateve të veprimtarisë kërkimore në Shqipëri.



Grup autorësh. Qytetërimi i Voskopojës dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan (përmbledhje kumtesash)

Viti i botimit: 2019

Faqe: 498

ISBN: 978 9928 237 63 7

Mbi librin

Ky botim është përmbledhja e kumtesave të mbajtura në konferencën shkencore ndërkombëtare kushtuar 250-vjetorit të lulëzimit të Voskopojës dhe pamjeve të iluminizmit europian në Ballkan.

Në këtë konferencë morën pjesë studiues të njohur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Greqia, Italia, Rumania dhe nga vende të tjera. Këto akte paraqesin, veç të tjerave, edhe një gjendje emancipimi në mendësinë dhe dialogun shkencor midis shumë aktorësh dhe faktorësh të interesuar për paradigmen themelore të konferencës dhe, pa dyshim, një rezultat pozitiv bashkëpunimi dhe sinergjie ndërballkanike.



Tirta, M., Mitologjia ndër shqiptarë

Faqe: 457


ISBN: 978-9928-237-58-3

Mbi librin

Në këtë monografi është synuar zbërthimi i një qerthulli dukurish të mitologjisë popullore shqiptare, duke u përqendruar tek ato më themeloret, më kryesoret, më të ruajturat, më të kapshmet e më tipiket për etnokulturën e kombit tonë.

Çdo çështje e veçantë është shqyrtuar mbështetur në një material të gjerë dëshmues, mbledhur në kërkime terreni, në arkiva e në literaturën e shkruar. Çdo element, çdo dukuri e mitologjisë popullore është gjurmuar në shtrirje të përmasave ndërkrainore e shpeshherë edhe mbaretnike, parë në vështrim diakronik e sinkronik, duke nxjerrë më të plotë brendinë e veçanësinë, origjinën e çdo riti e miti.

Në këtë vepër janë bërë përpjekje për të përfshirë një problematikë sa më të gjerë e për t'u hapur rrugë kërkimeve të mëtejshme.



Thëngjilli, P., Aliu midis historisë dhe legjendës.

Viti: 2019

Faqe: 1010


ISBN: 978-9928-237-75-0

Mbi librin

Kjo monografi, rezultat i një pune disavjeçare hulumtuese e krahasuese është e para në

historiografinë shqiptare që mbështetet mbi baza dokumentare që përfshijnë gjithë jetën e Ali pashë Tepelenës.

Dokumentet e hulumtuara nga autori në arkivat e Turqisë dhe nga bashkëpunëtorët e tij, si dhe ato të arkivit personal të Ali pashë Tepelenës, shfrytëzimi i dokumentacionit rus dhe atij anglez e francez dhe baza bibliografike tepër e gjerë në gjuhë të huaj dhe shqip, janë tipare që i japin epërsi kësaj vepre ndaj atyre paraardhëse mbi këtë temë.



Sina, H., Kodikët ekfonetike të Shqipërisë

Viti: 2019

Faqe: 312

ISBN: 978-9928-237-79-8

Mbi librin

Ky studim shkencor ka në fokus të trajtimit Kodikët ekfonetike të Shqipërisë, si një vlerë e padiskutueshme e trashëgimisë sonë kulturore e artistike. Rezultat i interesit për punën hulumtuese në arkivat shqiptare dhe, konkretisht, për dorëshkrimet e lashta muzikologjike të liturgjisë së krishterë, për të cilat nga studiuesit shqiptarë është shkruar shumë pak, kjo monografi është vetëm njëra nga pjesët e studimeve të Holta Sina Kilicës kushtuar dorëshkrimeve muzikologjike që ruhen në rrjetin arkivor të vendit.

Punimi synon të hedhë dritë mbi dorëshkrimet muzikologjike bizantine të Fondit 488 të Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH), duke sjellë të dhëna me interes shkencor të përveçuar, në fushën e muzikës bizantine. Rëndësia e studimit të këtyre dorëshkrimeve qëndron në faktin e vlerës së tyre të padiskutueshme historike, dokumentare, por dhe kulturore e artistike, duke dëshmuar në këtë kontekst lashtësinë e shkrimit dhe këndimit të kësaj muzike në vendin tonë. Mirëpo kjo vepër nuk mbetet ngushtësisht e fokusuar vetëm te specialiteti i fushës së muzikologjisë. Ajo prek, pa dyshim, edhe të tjera fusha të antropologjisë kulturore dhe studimeve të artit (etnografi, folklorit letrar, agjiografi – shkrime shenjtore, pikturë ikonografike etj.), në mënyrë që të plotësohet tërësia e procesit kërkimor të synuar.

Burimet bibliografike të konsultuara (literatura), rrokin një numër të konsiderueshëm titujsh të autorëve vendas dhe atyre të huaj, sidomos në lidhje me çështjen e periudhizimit të muzikës bizantine.



Haxhimihali Dh., Topi, D., Andoni E., Fjalor i termave bazë të kimitë

Viti: 2019

Faqe: 430

ISBN: 978-9928-237-66-8

Mbi librin

Fjalor shqip–anglisht dhe anglisht–shqip i terminologjisë bazë të kimitë u vjen në ndihmë gjithë kimistëve që duan të thellojnë njohuritë dhe studimet e tyre në këtë fushë. Ai është i ndarë në dy pjesë, ku gjuha e parë e këtij fjalori është shqipja dhe si

bazë referimi për saktësimin e kuptimit të termave është përdorur anglishtja.

Ky fjalor normativ ka 7000 terma njëfjalësh e togfjalësh, bazuar në fjalorin e parë të Frank Bardhit dhe deri te botimet më të fundit. Fjalori ka dy funksione, është normativ duke synuar të vendos norma mbi këtë fushë dhe është i pari në gjuhën anglisht.

Ndër të tjera fjalori ka një rëndësi të veçantë pasi jep kontribut në kuadër të mënjanimit të huazimeve të panevojshme duke i shqipëruar ato.



Grup autorësh. Akte të Konferencës “Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi

Ky botim është përmbledhja e akteve të konferencës së parë mbarëkombëtare shkencore të kërkuesve të rinj të organizuar me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që u zhvillua në 4 dhjetor 2017, në kuadër të veprimtarive për promovimin e Akademisë së të Rinjve, si organizëm i ri shkencor në Shqipëri.

Kërkimi shkencor në Shqipëri ka pësuar një ndryshim të thellë në shumë aspekte. Ndër më të rëndësishmit janë metodat kërkimore të zbatuara dhe metodologjitë e studimit si në shkencat shoqërore, ashtu edhe në ato natyrore e teknike. Një pjesë e kërkimeve ende realizohen me metoda dhe qasje interpretuese tradicionale, edhe pse prirja mbizotëruese është “reformimi” metodologjik. Kjo ka sjellë, në mënyrë të natyrshme, evidentime të fakteve të reja, analiza e qëndrime të tjera shkencore, interpretime të ndryshme, në kërkim të së vërtetës shkencore. “Vërshimi” i lirë i metodave kërkon, më së pari, edhe një diskutim në lidhje me to, për të qartësuar, përzgjedhur e braktisur metoda të caktuara, që nuk i përgjigjen realitetit të zhvillimit në Shqipëri.

Përmes prurjeve shkencore, propozimeve dhe diskutimeve, konferenca synon të çojë përpara debatin shkencor për një çështje kaq gjithëpërfshirëse dhe aktuale për studimin shkencor.

Hudhri, F. Shqiptarët në artin botëror.

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Në këtë vepër pasqyrohet në formën më të plotë historia e trajtimit të motiveve shqiptare nga artistët e huaj.

Kjo vepër vjen në lëmin e studimeve albanologjike me të dhëna të reja, informacion të ri shkencor, gjetje, zbulime, burime bibliografike, qasje, përshtypje nga takimet me të tjerët, galeri, skeda etj. Ai paraqet struktura të ngjeshura enciklopedike të zërave, artikujve, sythave që shënojnë emra të veçantë artistësh nga bota, tablo e vepra të veçanta që kanë fiksuar në ngjyra e silueta figura shqiptarësh nga më të larmishmet.

Burimet janë të shumta dhe tejet të fyllëzuara, konkrete, të përimitëzuara, saqë çdo studiues i ri do të kishte çfarë të çmontonte e të përfitonte, në mos të merrte e ta aplikonte si eksperiencë.

Kjo enciklopedi ka karakter shterues, mbi 1100 piktorë, skulptorë e grafistë dhe mbi 1400 riprodhime të zgjedhura dhe disa mijëra njësi bibliografike e burime të larmishme në disa gjuhë.

Dado, F. *Postmodernizëm në letërsinë e sotme shqiptare.*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Kjo vepër trajton për herë të parë një dukuri letrare që u shfaq dukshëm pas viteve '90. Vepra është konceptuar në dy plane: plani teorik, ku sqarohen për lexuesin koncepte të tilla të rëndësishme, si modernia / modernizmi; postmodernia / postmodernizmi.

Synimi kryesor ka qenë që, mbi bazën e njohjes së poetikave në vepra të letërsisë sonë (përqendruar te romani) dhe mbi bazën e njohjes së gjerë të teorive postmoderniste, të shprehen pikëpamjet e autores, dakordësitë por sidomos mospëlqimet, parë në dy raporte: a) në aspektin e thelbit të letërsisë dhe rolit të saj në jetën shpirtërore të shoqërisë, dhe b) në gjykimin e perspektivës historiko-letrare të këtij zhvillimi.

Në strukturën e punimit, parimi ka qenë qartësia, larg lojërave shprehimore, manisë së emërtimeve 'interesante', që duken si shkencë 'moderne', duke pasur si tipar konceptin e qartësisë së trajtimit, të stilit të drejtpërdrejtë shkencor, si tipar i palëkundshëm në çdo lloj shkence.

Velo, M. *Studime mbi arkitekturën dhe artin popullor*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Ky botim është një përmbledhje me artikuj e studime mbi detajet arkitekturore në banesën shqiptare. Ndër detajet arkitekturore të banesës qytetare, që paraqesin vlera artistike dhe që meritojnë studim të veçantë, janë edhe elementet e aplikuarra te portat.

Elementet e marra në studim flasin për një sens artistik të zhvilluar, për një aftësi të veçantë të lidhjes së arteve të aplikuarra me arkitekturën. Fondi i arteve të aplikuarra popullore, kështu, pasurohet edhe me këto detaje, të cilat janë plot fantazi, pasuri mendimi e ritmi dhe kanë një forcë stilizuese herë-herë për t'u admiruar. Punimet artistike të hekurit janë të shumta në banesë, që nga ato të përdorimit të përditshëm: zinxhirë për të varur, mbajtëse drush, deri në ato të vendosura në banesë si kangjella dritarësh e ballkonësh, dyer etj. Ato që janë paraqitur në libër janë vetëm një pjesë e vogël e punimeve që kryenin farkëtarët për banesën qytetare, pasi farkëtaria ka qenë një zeytari e përhapur mjaft në qytetet tona.

Hado, A. *Portreti - 120 vjet histori të pikturës shqiptare*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Ky botim mbi pikturën e portretit në Shqipëri do të shërbejë për të njohur më mirë ecurinë historike, faktorët e zhvillimit dhe të frenimit të vlerës në këtë art. Sidomos disa fenomene konceptuale, estetike, ideologjike, metodike të periudhës së komunizmit në vendin tonë.

Libri prek jo vetëm aspektin historik, por më tepër analizon fenomenet e zhvillimeve dhe problemeve të frenimit të vlerave në periudha të caktuara në artin shqiptar, pasi piktura e portretit është një nga llojet më të vjetra dhe më komplekse që ka shënuar

vlerat e para reale. Sigurisht që në ecurinë e këtij arti ka edhe momente të vështira ku gjejmë pasiguri, vlera minimale, të cilat merren në shqyrtim në vepër.

Studimi arrin të vlerësojë artin e portretit, për vlerat që arriti në disa periudha historike, ashtu sikundër evidenton mungesën e kësaj vlere në disa momente, veçanërisht gjatë realizmit socialist.

Papagjoni, J. *Enciklopedia e artit shqiptar.*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Kjo enciklopedi është e para e këtij lloji në Shqipëri dhe shënon një ngjarje të rëndësishme në studimet albanologjike mbi artin shqiptar.

Ajo përfshin gjithsej 2000 zëra enciklopedikë dhe është një bankë të dhënash për gjithë artin shqiptar, duke i shërbyer kështu kujtesës kulturore dhe historike të kombit tonë.

Onuzi, A. *Art popullor në Kosovë.*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Ky botim shkencor ilustrativ vjen në vijim të botimeve të mëparshme të kësaj natyre, lidhur me krijimtarinë atistike të mjeshtrave popullorë fshatarë dhe qytetarë në krahinat e ndryshme brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë.

Frashëri, Gj. *Kruja e Skënderbeut.*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Kjo vepër paraqet gjithë historinë e qytetit të Krujës prej fillesave të saj si vendbanim, themelimit të saj si qytet i fortifikuar, zhvillimit të saj prej mesjetës së hershme, në kohën e principatave dhe deri në shek. XV.

Resuli, B. *Abdomeni akut (handbook)*

Viti i botimit: 2019

Faqe:

ISBN:

Mbi librin

Kjo vepër sjell një kontribut të rëndësishëm në literaturën tonë mjekësore, pasi lidhet me një prej sfidave madhore të praktikës së përditshme, atë të diagnostikimit të hershëm të shkaktarit të abdomenit akut.

Aneks nr. 5

Veprimtaria shkencore individuale e anëtarëve të Asamblesë⁵

I. Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare në kuadër të programeve të BE (FP6 dhe FP7 etj.) dhe të organizatave të tjera

I-A: Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA)

1. Akad. Anastas Angjeli:

1.1. *Empowered zone a head capacity building in the field of youth*, projekt i mbështetur nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim;

1.2. *Governance model for Industry 4.0 in the Adriatic-Ionian*, projekt i IPA-INTERREG Adrion Programme 2014-2020;

1.3. *Communities That Care! A community-wide coalitions response to violence extremism in Tropoja Municipality*; projekt i UNDP;

1.4. *Assessing and Improving the Research Performance in Albania and Kosovo*, projekt i ERASMUS KA2-CBHE.

2. Akad. Artan Fuga:

2.1. Bashkëdrejtues e pjesëmarrës i projektit kërkimor ***Strategjitë e programacionit dhe sfidat e transmetimeve televizive në Shqipëri*** (2018-2019), në shtyp;

2.2. Bashkëdrejtues e pjesëmarrës i projektit kërkimor ***Tregu i medias audiovizive, sjellja e audiencave e kuadri rregullator***, në shtyp;

2.3. Bashkëdrejtues i sondazhit të opinionit publik kombëtar ***Sjellja dhe perceptimi i audiencave kombëtare përballë programacionit të ofertave televizive në Shqipëri***, 2018-2019;

⁵ Mbështetur në raportimet vjetore vetjake. Botimet në shtypin e përditshëm dhe në rrjetet sociale, shkrimet popullore dhe intervistat, bisedat televizive, nuk janë pjesë e këtij aneksi.

2.4. Bashkëdrejtues i sondazhit të opinionit publik kombëtar *Proceset rregullare në tregun e medias audiovizive në Shqipëri dhe sjellja konsumatore e audiencave*, në proces botimi.

3. Akad. Aurela Anastasi:

3.1. Eksperte e projektit *Mbështetja e mjeteve juridike efektive vendëse dhe lehtësimit i ekzekutimit të vendimeve në Shqipëri*, sintetizuar në publikimin *Përfshirja e mësimit praktik të të drejtave të njeriut në programet mësimore*;

3.2. Eksperte lokale e UNDP për realizimin e projekteve *Për përmirësimin dhe forcimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen nga dhuna në familje*, bashkëpunim ndërinstitucional;

3.3. Eksperte lokale e OSBE-ODHIR për projektin *Të drejtat e viktimave të trafikimit gjatë procesit penal*, në proces botimi në *Komentari i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore*.

4. Akad. Marenglen Verli:

4.1. Drejtues i kolanës së botimeve të *Vitit të Skënderbeut*;

4.2. Drejtues i kolanës me 5 vëllime me dokumente të diplomacisë austro-hungareze: *Princi Vidi dhe Shqipëria në dokumentet austro-hungareze në vitin 1914*.

5. Akad. asoc. Shaban Sinani:

5.1. Këshilltar për projektin shkencor të regjistrimit të *Festivalit Folklorik Kombëtar* në programin ndërkombëtar *Best Practice of UNESCO*;

5.2. Vlerësues i jashtëm për literaturën shkencore të këshilluar në universitete *për agjencinë europiane ANVUR*;

6. Akad. Vasil S. Tole:

5.1. Drejtues i projektit ndërkombëtar *për regjistrimin e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në programin e praktikave më të mira të ruajtjes së trashëgimisë kulturore jomateriale të UNESCO-s (Good Safeguarding Practice)*.

I-B: Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore (SSHTN)

1. Akad. Efigjeni Kongjika:

1.1. *Përmirësimi i mikroshumimit në një shkallë të gjerë të disa prej llojeve të dru frutoreve ekonomikisht të rëndësishme përmes teknologjisë inovative të kulturës së lëngshme me zhytje të përkohshme (Temporary Immersion System, TIS)*, projekt bilateral ASH-CNR, Itali. ASH është agjencia ekzekutive;

2. Akad. Neki Frashëri:

2.1. Projekt bashkëpunimi ASH-ASHAK *për studimin e mjedisit me imazhet satelitore*. Është bërë përpunimi i dy serive të imazheve radar SENTINEL2 për lëvizjet e truallit dhe imazheve LANDSAT për indeksin e bimësisë;

2.2. Në vazhdim të **projektit HP-SEE të programit evropian FP7 dhe aksionit evropian COST NESUS** përfundoi studimi i ndikimit në inversionin e anomalive të gravitetit i pozicionit reciprok të trupave 3D dhe përgatitja e një artikulli për JNTS.

3. Akad. Arben Merkoçi:

3.1. **Development of a Nanodiagnostic platform for monitoring of Cancer cell secreted proteins** (NACANCELL); 2016-2019, project funded by MINECO;

3.2. **Development and application of Novel, Integrated Tools for monitoring and managing Catchments** (INTCATCH); 2016-2020, European Commission Program H2020;

3.3. **Integrated smart, cost and effective nanodiagnostics**, INCOSTNANO; 2017-2019; project funded by MINECO;

3.4. **Graphene flagship core 2**, funded by European Commission; 2018-2020;

3.5. **MICROBiome-based biomarkers to PREDICT decompensation of liver cirrhosis and treatment response** (MICROB-PREDICT); European Commission, 2019-2025.

4. Akad. asoc. Arjan Durrësi:

4.1. **INFEWS/T2: iFEWCoordNet - a secure decision support system for coordination of adaptation planning among FEW actors in the Pacific Northwest**, NSF-USDA, 2017-2020;

4.2. **Secure Data Architecture: Collaborative Research: Assured Mission Delivery Network Framework for Secure Scientific Collaboration**, NSF, 2015-2020.

5. Akad. Jorgaq Kaçani:

5.1. **Shkëmbimi i stafit akademik të UPT dhe studentëve të UPT me Universitetin e Poitiers**, 2018-2020, programi evropian ERASMUS+, koordinator i projektit;

5.2. **Dixhitalizimi dhe eksperiencia 3D në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit turistik**, 3D-IMP-ACT.

II. Pjesëmarrje në kongrese, konferenca eseminare shkencore

II.1. Pjesëmarrje në veprimtari shkencore jashtë vendit:

II.1-A. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA)

1. Akad. Anastas Angjeli:

1.1. **“Stoku i kapitaleve” në tregun unik shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore**, kumtesë në konferencën *Albanians and the region during the Great War*;

1.2. **The Impact of Economic Policy in Increasing the Value of Human Capital Stock in Albania**; kumtesë në konferencën *Academic Studies in Human Education and Social Sciences*.

2. Akad. Aurela Anastasi:

2.1. *For a broader understanding of some institutes of the legislation on protection against discrimination*, kumtesë në konferencën ndërkombëtare *Institutions, ideas, and the challenge of democracy in the 21st century*, në University of Economics, Prague.

3. Akad. Albert Doja:

3.1. *Récits de guerres balkaniques dans l'industrie médiatique et les politiques internationales*, kumtesë në Kongresin XII të AIESEE-së;

3.2. *On Mobility and Migration: A contrastive framework for advocative approach and critical analysis of fundamental freedoms and constraints*, workshop, Paris 2019.

4. Akad. Artan Fuga:

4.1. *Sistemet e përjashtimit në media, politikë, shoqëri sipas një përqsasje funksionaliste*, në konferencën *Strategjitë e programacionit dhe sfidat e transmetimeve televizive në Shqipëri*.

5. Akad. Beqir Meta:

5.1. *Ndikimi i faktorëve ndërkombëtarë në rezultatet e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës gjatë shek. XX*, në konferencën ndërkombëtare me temë *Kosova - rruga drejt lirisë*.

6. Akad. Floresha Dado:

6.1. *The Four Concordats Between the State and Religious Communities During the Royal Period in Albania (1928-1939)*, kumtesë në Kongresin XII Ndërkombëtar të AIESEE-së;

6.2. *Prometeizmi në letërsinë shqipe (Prometeo in Albania: Passaggi letterari e politici di un paese balcanico)*, në konferencën ndërkombëtare *Studimet albanistike në Itali*, Prishtinë 2019;

6.3. *Poezi apo rrëfenjëza të vargëzuara?*, kumtesë në konferencën ndërkombëtare kushtuar 200-vjetorit të Santorit, Kozencë 2019.

7. Akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj:

7.1. *Abdulla Zymberi - gjurmues i palodhshëm e dorëmbarë i leksikut dialektor të shqipes*, kumtesë në Prizren.

8. Akad. Jani Thomai:

8.1. *Fjalë e shprehje popullore*, kumtesë në konferencën shkencore *Leksiku krahinor dhe leksikografia dialektore*, IAP 2019;

8.2. *Abdulla Zymberi leksikograf*, kumtesë në konferencën *Jeta dhe vepra shkencore e Abdulla Zymberit*, Prizren 2019.

9. Akad. Marenglen Verli:

- 9.1. *Rugova në projektet e KMKK për realizimin e aspiratave kombëtare në Kosovë*, në konferencën *100-vjetori i masakrës së Malit të Zi në Rugovë më 1919*;
- 9.2. *Lëvizja Kombëtare dhe situata në Manastir në vitet 1905-1906 sipas Sejfi Vllamasit*, në konferencën *Personalitetet e Rilindjes Kombëtare dhe veprimtaria e tyre në Manastir*;
- 9.3. *Çështja e Kosovës dhe stabiliteti i shtetit shqiptar gjatë shekullit XX*, në konferencën shkencore ndërkombëtare *Kosova - rruga drejt lirisë*;
- 9.4. *Situata demografike, etnike, fetare dhe ekonomike në Kosovë, në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, në konferencën *Java e Albanologjisë*.

10. Akad. asoc. Shaban Sinani:

- 10.1. Anëtar i komitetit shkencor ndërkombëtar të organizimit të *konferencës kushtuar 200-vjetorit të Santorit*, Itali; anëtar i komitetit shkencor organizator të *Konferencës së 50-të Botërore të Studimeve për Baladat (50th International Conference of Ballads)*;
- 10.2. *Jews in Albania during Holocaust*, në konferencën shkencore *A Matter of Humanity: the Rescue of the Jews in Albania during the Holocaust*, organizuar nga OKB, New York 2019;
- 10.3. *Due monografie in versione manoscritta su Francesco Santori nell'Archivio dell'Istituto di Studi linguistici e Letterari di Tirana*, në konferencën për Santorin, Itali;
- 10.4. *"Codex Purpureus Beratinus" in UNESCO's "Memory of the World" Programme*, në Kongresin XII të AIESEE-së.
- 10.5. *Social literature in the Balkans during the first half of the XXth century*, kumtuar në Universitetin e Studimeve Ndërkombëtare të Pekinit (BFSU);
- 10.6. *Religions in Balkan*, ligjëratë e hapur universitare me studiuues të Institutit të Studimeve Ballkanologjike të BFSU (*Open lecture on Balkanology*);
- 10.7. *Medieval Ballads in Balkan: Dilemma Between the Most & the Castle*, ligjëratë e hapur universitare në Institutin e Studimeve Ballkanologjike të BFSU;
- 10.8. *Miqjeni and Kosta Racin in context of social literature of Balkan*, ligjëratë akademike në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, miratuar si projekt ndërakademik.

II.1-B. Seksioni i Shkencave Teknike dhe Natyrore (SSHTN)

1. Akad. Neki Frashëri:

- 1.1. *Internet Complexity and Social Integration*, simpoziumi *Complexity & Integration in Nature and Society*, organizuar nga European Academy of Sciences & Arts & German-Japanese Society of Integrative Science (me akad. Gudar Beqirin).

2. Akad. Nazim Gruda:

- 2.1. *The impact of elevated CO2 on yield of greenhouse vegetables*, *International Symposium on Advanced Technologies and Management for Innovative Greenhouses*, France, *Book of Abstracts* (me J. Dong, X. Li, Z. Duan);

2.2. Invited speaker: **Die Torfminderungsstrategie - Ein Jahresrückblick und wie es weitergeht. Projektabschlussveranstaltung: Torffreie Erden aus der Region – utopisch oder realistisch?**, Europäische Fachzentrum Moor und Klima, Wagenfeld-Ströhen;

2.3. Invited speaker: **Soilless Culture: Which Growing Media is the Best Choice?**, 8th International Conference on Water Resources and Arid Environment;

2.4. Invited speaker: **Bericht zur Torfminderungsstrategie. 4. Plenarsitzung vom Nds. Torfersatzforum Nachhaltiger Torfersatz aus Nachwachsenden Rohstoffen für den Gartenbau**, Hannover;

2.5. **Greenhouse soil warmed by capillary network and its effect on the growth of cucumber**, International Symposium on Advanced Technologies and Management for Innovative Greenhouses, France, Book of Abstracts (me J. Dong , X. Li, Z. Duan).

3. Akad. Jorgaq Kaçani:

3.1. 2nd International Conference **Engineering and Entrepreneurship**, organizuar nga UPT dhe Universiteti i Prishtines Hasan Prishtina;

4. Akad. Efigjeni Kongjika:

4.1. **Preservation of rare and endemic plants through in vitro conservation methods: A case study of genus Ramonda from Balkan Peninsula**, 338th Meeting Eastern Alpine and Dinaric Society for Vegetation Ecology Colfiorito - Italy, (me B. Gashi dhe M. Osmani);

4.2. **La necessità di introduzione di metodi innovativi nella produzione di piantine di specie di alberi da frutto in Albania**, tavola rotonda Coltura liquida in immersione temporanea (TIS): Risultati di un progetto bilaterale tra CNR-IBE d'Italia e Accademia delle Scienze d'Albania, Firenze;

4.3. **Micropropagation of Myrtus communis L and comparison of epidermal glandular trichomes characteristics between in vivo and ex vitro plantlets**, 1st International Symposium on Climate Change and Sustainable Agriculture, Bullgari, Abstract Book (me V. Sota e B. Çuko);

4.4. **Micropropagazione convenzionale di specie da frutto spontanee in Albania e miglioramento delle tecniche di propagazione mediante ElecTIS**, tavola rotonda Coltura liquida in immersione temporanea (TIS): Risultati di un progetto bilaterale tra CNR-IBE d'Italia e Accademia delle Scienze d'Albania, Italia (me V. Sota e B. Çuko).

5. Akad. asoc. Ilirjan Malollari:

5.1. **Analysis of Ichthyic Types Parasites in the Albanian Part of Ohrid Lake**, International Symposium for Environmental Science and Engineering Research (ISESER) Turkey; Abstract Book of ISESER 2019 (me M. Shyqeriu, R. Sadikaj, D. Arapi);

5.2. **Impact of Pollution Causing Water Turbidity on Ohrid Lake Over Transparency Values Secchi (ZSD, m) AND EUPHOTIC DEPTH (Zeu, m)**, International Symposium for Environmental Science and Engineering Research (ISESER) Turkey; Abstract Book of ISESER 2019, (me M. Shyqeriu, R. Sadikaj, D. Arapi);

5.3. **Water distillation extraction of clove (Syzygium aromaticum L.) oil and water purification after extraction: A spectroscopic study**, ISCW2019 International Symposium On Constructed Wetlands & Small Decentralized Wastewater Treatment Plants, Greece; Book of Abstracts (me K. Taraj, J. Llupa, F. Ylli, A. Ylli, R. Hoxha, R. Andoni);

5.4. **Treatment of the waste water solutions from biodiesel production for environmental protection and chemicals obtaining**, ISCW2019 International Symposium On Constructed

Wetlands & Small Decentralized Wastewater Treatment Plants, Greece, *Book of Abstracts* (me S. Gjeta dhe A. Mazreku);

5.5. Study on some alternative fuels used for the cement clinker production and the process simulation, 8th International Conference on Business, Technology and Innovation, Kosovë, *Book of Abstract* (me E. Karakashi dhe M. Xhango);

5.6. Invited lecture, Using instrumental analysis for determining food authenticity, adulteration and food safety, International Conference on Instrumental Methods of Analysis, Modern Trends and Applications, Greece; *Book of Abstracts* (me H. Mana, R. Buzo, A. Dhroso);

5.7. New Consideration for Biodiesel Small Scale Production Using Modeling and Simulation Technics, International Symposium for Environmental Science and Engineering Research (ISESER), Turkey; *Abstract Book of ISESER 2019* (me A. Mazreku dhe I. Beqiraj);

5.8. Characterizing of the Raw Materials and Utilities for the Laboratory-Scale Biodiesel Production, International Symposium for Environmental Science and Engineering Research (ISESER), Turkey, *Abstract Book of ISESER 2019* (me A. Mazreku, L. Liçi).

6. Akad. Arben Merkoçi:

6.1. Graphene technologies for the new generation of medical devices and diagnostics, invited talk at *Graphene Connect & Health Investment Forum*, Barcelona (me K. Kostarellos);

6.2. Paper-based nanobiosensors, Invited talk at *Editorial session: Elsevier biosensors and bioelectronics*, at Euroanalysis Conference, Turkey;

6.3. Graphene-based biosensors for diagnostics, Keynote presentation at *Graphene and 2D Materials Conference and Exhibition*, Brazil; idem, New York, USA; ibidem, Mackgraph Center, Mackenzie Presbyterian University, São Paulo, Brasil; ibid ibidem, Plenary lecture at Euroanalysis Conference, Istanbul, Turkey, September 2-5, 2019;

6.4. Graphene-based platforms for diagnostics, Invited presentation at *9th Edition of European Conference in Graphene and 2D Materials*, Italy;

6.5. Integrated Smart Effective Nanodiagnostics, Invited Talk at WuHan University of Science and Technology, Wuhan, China;

6.6. Nanobiosensors for Diagnostics Applications, Invited at The Hong Kong University of Science and Technology, Hong Kong; idem at Keio University, Japan; ibidem, keynote talk at *Point-of-Care, Biosensors & Mobile Diagnostics Europe 2019*, Netherland; bis at London Centre for Nanotechnology & Università degli Studi di Padova, Italy;

6.7. Nanobiosensors for diagnostics: from health, environment to safety and security applications, Invited talk at University of Freiburg; idem at University California San Diego (UCSD); ibidem, Barcelona Institute of Science and Technology (BIST), Barcelona; bis, keynote talk at CIS2019 Conference *Chemistry meets Industry and Society*, Italy;

6.8. Nanobiosensors for food safety and security and environment applications, Invited Lecture, XVIII Workshop *rapid methods and automation in food microbiology*, Barcelona; idem The National Institute of Chemistry, Ljubljana, Slovenia;

6.9. Nanomaterial-based devices for diagnostics applications, Invited talk at Okinawa Institute of Science & Technology Graduate University; idem at CUNY Graduate Center, USA;

6.10. Paper-based nanobiosensors: diagnostics going simple, *NanoBioMed Conference*, Barcelona; idem, keynote presentation at *SelectBIO Point-of-Care Diagnostics, Biosensors & Global Health 2019 Conference*, San Diego, USA;

6.11. *Smartphone coupled paper-based nanobiosensor for cancer biomarkers detection*, Invited talk at 5th EuroNanoMed Review seminar for funded projects, Bratislava, Slovakia.

7. Akad. Edmond Pinguli:

7.1. *Ndryshimet klimatike dhe ngrohja globale: mungesa e ujit në botë dhe në Shqipëri*, Complexity & Integration in Nature and Society, European Academy of Sciences & Arts & German-Japanese Society of Integrative Science, Salzburg.

II.2. Pjesëmarrje në veprimtari shkencore brenda vendit:

II.2.A. Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA)

1. Akad. Anastas Angjeli:

1.1. *Politika e Shteteve të Bashkuara në Ballkanin Perëndimor*; kumtesë në konferencën *US Policy in the Western Balkans*;

1.2. *Challenges of Albanian higher education for coping with the needs of digital labor market*; kumtesë në konferencën *Innovation, Mathematics and Information Technology 2019*.

2. Akad. Aurela Anastasi:

